



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 34 regjistër (JR)
Datë 10.09.2020

Nr. 35 i vendimit
Datë 22.09.2022

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Mimoza Tasi	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 22.09.2022, ora 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier De Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 34 (JR), datë 10.09.2020, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 254, datë 04.06.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës; ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”; ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”),

shqyrtoi pretendimet e kërkimet e saj të paraqitura në ankim dhe në seancë gjyqësore, e cila kërkoi përfundimisht ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 254, datë 04.06.2020 dhe konfirmimin e saj në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj Entela Shedula, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, ushtronte detyrën e gjyqtares dhe njëkohësisht kryetares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe, për rrjedhojë, ajo gëzonte statusin e magjistrates¹. Në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, znj Entela Shedula iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente brenda afatit ligjor², në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë³, deklaratën për kontrollin e figurës⁴ dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁵.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) *Deklarimi është i saktë.*
 - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
 - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
 - (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
 - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport⁶ të arsyetuar pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Me anë të këtij raporti, DSIK-ja përcaktoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të

¹Neni 2, pika “gj” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se magjistrat është edhe gjyqtari, ndërkohë neni 164, pika 2 e të njëjtit ligj parashikon se gjyqtarët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit, të parashikuar sipas të njëjtit ligj vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit.

² Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaramit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

³ Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 27.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së nr. {***}, datë 27.01.2017. Të njëjtën datë mban dhe deklarata e pasurisë në rubrikën përkatëse.

⁴ Referuar raportit mbi kontrollin e figurës të përgatitur nga grupi i punës pranë DSIK-së.

⁵ Referuar raportit nr. {***} prot., datë 16.05.2018, të Inspektoratit pranë KLD-së për “Analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Entela Shedula për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar formularin e vetëdeklaramit më datë 27.01.2017.

⁶ Dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017.

saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore dhe se, lidhur me subjektin e rivlerësimit, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Grupi i punës konstatoi përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, për vazhdimin e detyrës.

5. Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Entela Shedula, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë vendimin nr. 254, datë 04.06.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 254, datë 04.06.2020, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, me detyrë gjyqtar/drejtues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme.

8.1. Në përfundim të hetimit të kryer në zbatim pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat e administruara nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancat dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula: (i) nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, të parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve; (iii) ka deklarim të pasaktë në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat i bashkëshortit; (iv) deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

9. Subjekti i rivlerësimit iu drejtua Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar “Kolegji”) me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 254, datë 04.06.2020, me pretendimin se vendimi është i pabazuar në ligj dhe rezultat i cenimit dhe shkeljes së normave dhe rregullave ligjore për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, por edhe vlerësimit të gabuar të rrethanave faktike të rezultuara e vërtetuara gjatë procesit administrativ për hetimin dhe vlerësimin e kriterit të pasurisë. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi objekt ankimi është rezultat i një procesi të paragjykuar, hetimi të cekët dhe të orientuar nga qëllimi për të përfunduar sa më parë procesin me përfundimin e paracaktuar të shkarkimit nga detyra, si dhe mungesës së analizës së provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

10. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, nuk e shoqëroi ankimin e saj me akte shkresore, për të cilat të kërkonte marrjen në cilësinë e provave të reja. Bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a”, 63, pika 1, 65 e 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenet 47, 51, pika 1, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012, si dhe në nenet 108, 109 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe të vendosë:
- *Pavlefshmërinë absolute/paligjshmërinë e vendimit nr. 254, datë 04.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, kthimin në detyrë.*
 - *Gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike.*
 - *Konstatimin e shkeljeve të të drejtave kushtetuese, si dhe ato të parashikuara nga KEDNj-ja, ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, gjyqtare/drejtuese e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.*
 - *Ndryshimin e vendimit nr. 254, datë 04.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhënë për subjektin e rivlerësimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula.*
11. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale, si dhe ato të zbatimit të ligjit material, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.
- 11.1.** *Ndaj subjektit të rivlerësimit është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në kuptim të nenit 42 e 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, si dhe nenit 4, pikat 5 dhe 6, nenit 52, pika 1 dhe nenit 57 të ligjit nr. 84/2016, si dhe neneve 108, 109 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, pasi seanca e dhënies së vendimit është zhvilluar pa praninë e punonjësit administrativ/sekretares gjyqësore.*
- 11.2.** *Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”), në drejtim të mosrespektimit të parimit të gjykimin nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, për sa kohë i njëjti komision që ka bërë hetimin administrativ, mbledhjen e provave dhe ngritjen e dyshimeve, i njëjti komision (me të njëjtët anëtarë) ka dhënë edhe vendimin përfundimtar në rolin e gjyqtarit.*
- 11.3.** *Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, pasi vendimi objekt ankimi nuk është marrë nga një gjykatë e caktuar me ligj.*
- 11.4.** *Komisioni ka shkelur parimin e gjykimin nga një gjykatë e paanshme pasi (i) vendimmarrja e Komisionit e bazuar në një kriter, atë të pasurisë, është paragjyqëse dhe tërësisht në kundërshtim me nenin 7 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe cenon standardet e procesit të rregullt ligjor; (ii) trupa gjyqësore ka paragjykuar çështjen, duke qenë se është futur në seancë dëgjimore pa lexuar kundërshtimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe duke kërkuar nga subjekti që kundërshtimet t’i paraqiste në mënyrë të përmbledhur, ndërkohë që vetëm në sja të këmbënguljes së subjektit për të dhënë shpjegime në detaje, është vendosur të riçelet hetimi administrativ.*
- 11.5.** *Komisioni ka cenuar nenin 8 të KEDNj-së pasi në rastin objekt gjykimi, masa e dhënë për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.*
- 11.6.** *Komisioni ka cenuar nenin 14 të KEDNj-së për shkak se nuk është zbatuar parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit. Subjekti pretendon se, referuar vendimeve të Komisionit për subjekte të tjera rivlerësi, të ndodhura në të njëjtën situatë faktike si subjekti i rivlerësimit, znj.*

Entela Shedula, ai ka mbajtur qëndrime të ndryshme duke i konfirmuar në detyrë, ndryshe nga çka vepruar me znj. Shedula.

11.7. *Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 1, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme. Komisioni ka vendosur në kundërshtim edhe me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kritereve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.*

11.8. *Komisioni ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të kuptimit të konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm.*

12. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

i. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “godinë e kombinuar 3-katëshe”, me nr. pasurie {***}, ZK {***} dhe vendndodhje Kavajë:

12.1. *Konkluzioni i Komisionit për deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë “vetting” dhe atë periodike për mënyrën e fitimit të pronësisë së truallit mbi të cilin është ngritur ndërtesa 3-katëshe, e cila sipas Komisionit duhej të ishte deklaruar sipas statusit ligjor që ka pasur kjo pasuri, është i pabazuar në fakte.*

12.2. *Subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar analizën financiare të Komisionit lidhur me verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt kontrolli në drejtim të: (i) vlerësimit të kredive të marra pranë Fondacionit⁷ B. në vitet 2000-2001; (ii) moskonsiderimit si burim të ligjshëm të përdorimit në vitin 2006 të një pjese të kredisë së marrë pranë Bankës Tirana në vlerën e 2.000.0000 në vitin 2005; (iii) vlerësimit të gabuar të të ardhurave të realizuara nga paga e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. F. Sh., si i punësuar pranë shoqërisë “{***}” ShPK, për vitin 2008; (iv) përllogaritjes së vlerës totale të investimit për ndërtimin e banesës 3-katëshe.*

ii. Lidhur me pasurinë e luajtshme të llojit automjet, i tipit “Mitsubishi”, me vit prodhimi 2002, të blerë në vitin 2009, në vlerën e 5.000 eurove:

12.3. *Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar në fakte konkluzionin e Komisionit për mospërputhje të deklarimeve të subjektit lidhur me krijimin e kësaj pasurie dhe dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.*

iii. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për vitet 2008-2016, si i punësuar pranë shoqërive “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK:

12.4. *Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, kundërshtoi si të gabuar dhe të pabazuar përllogaritjen e Komisionit lidhur me të ardhurat nga paga të bashkëshortit të saj për periudhën 2008-2016, si i punësuar pranë shoqërive “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK.*

iv. Lidhur me rezultatin e analizës financiare për vitin 2012:

⁷ Tani Fondi B.

12.5. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, kundërshtoi si të gabuar konkluzionin e Komisionit për rezultatin negativ të analizës financiare të kryer për vitin 2012, me pretendimin se të ardhurat e bashkëshortit të saj nga paga si i punësuar pranë shoqërisë “{***}” ShPK, nuk janë përlllogaritur në mënyrë të saktë, në përputhje me vlerat e arkëtuara në bankë, sipas lëvizjeve të llogarisë bankare të pagës.

13. Lidhur me shkaqet e paraqitura në ankim, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, depozitoi brenda afateve ligjore parashtrimet e saj para Kolegjit, të cilat i shoqëroi me disa akte shkresore, për të cilat kërkoi nga trupi gjykues të administrohen në cilësinë e provave të reja në proces. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit nr. 254, datë 04.06.2020 dhe konfirmimin e saj në detyrë.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

14. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, znj. Entela Shedula, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

15. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁸ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

16. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me

⁸ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 254, datë 04.06.2020, për rivlerësimin e subjektit, znj. Entela Shedula, i është njoftuar asaj me shkresën {***} prot., datë 06.07.2020 (në shkresë viti është shënuar 2019), konfirmuar marrja dijeni nga subjekti i rivlerësimit më datë 10.07.2020, sipas lajmërim-marrjes së shërbimit postar. Kurse ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar në Komision në datën 20.07.2020, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit nr. {***}, datë 20.07.2020, që rezulton të jetë dita e 10 nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, e ka dorëzuar ankimin e saj në Komision brenda afatit ligjor për të ushtruar ankim, në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 254, datë 04.06.2020, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi. Gjatë shqyrtimit në dhomë këshillimi, lidhur me shkakun e ngritur në ankim nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, se ndaj saj është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, neneve 42 e 179/b, pika 2 e Kushtetutës, neneve 4, pikat 5 dhe 6, 52, pika 1 dhe 57 të ligjit nr. 84/2016, si dhe neneve 108, 109 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, pasi seanca e dhënies së vendimit ishte zhvilluar pa praninë e punonjësit administrativ/sekretares gjyqësore, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit lidhur me procedurat e ndjekura prej këtij të fundit, konstatoi si më poshtë.

16.1. Në vendimin e Komisionit nr. 254, datë 04.06.2020, në pjesën hyrëse të tij shkruhet: *Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga: [...] asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. E. H., në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar [...], në datën 11.03.2020, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve) salla B, kati 0 (underground) Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket: [...].* Ndërsa në faqen e fundit të vendimit, faqe nr. 27, konkretisht në krah të tekstit: “Sekretare Gjyqësore E. H.”, është vendosur numri 34, i poshtëshënimit në të cilin shkruhet: *Për arsye objektive, sekretarja gjyqësore E. H. ka qenë në mungesë ditën e shpalljes së vendimit.* Poshtë emrit të sekretares gjyqësore si më sipërcituar, është vendosur edhe një nënshkrim.

16.2. Në procesverbalin e shpalljes së vendimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Entela Shedula, të mbajtur me shtypshkrim në datën 04.06.2020, ora 09:45, në ambientet e Pallatit të Kongreseve, nuk referohet asgjë në lidhje me prezencën apo mosprezencën e sekretares gjyqësore. Ky procesverbal rezultoi të jetë nënshkruar nga anëtarët e trupit gjykues dhe *sekretare gjyqësore znj. E. H.*, ndonëse referuar poshtëshënimit nr. 34 të vendimit të Komisionit, kjo sekretare gjyqësore nuk ka qenë prezente atë ditë gjatë shpalljes së vendimit. Ndërkohë, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit, konstatohet se në fashikullin nr. 14 të Komisionit, në zarfin e numërtuar me nr. 2459, me shënimin në inventarin e këtij fashikulli, “Procesverbale seancash dëgjimore + shpallje vendimi + CD”, ndodhet një bartës të dhënash i llojit CD, i cili nuk është i lexueshëm dhe, për rrjedhojë, pamundëson verifikimin nga ana e trupit gjykues të ekzistencës dhe përmbajtjes së procesverbaleve audio (nëse ka të tillë) të seancës së shpalljes së vendimit të Komisionit.

16.3. Në procesverbalin e vendimmarrjes së Komisionit, të mbajtur më datë 01.06.2020, në rubrikën “Procesverbali i mbajtur nga”, nuk ka asnjë shënim. Në tërësi, në përmbajtje të këtij procesverbali, nuk ka referencë të sekretares gjyqësore që ka asistuar trupin gjykues në ditën kur janë zhvilluar bisedimet e trupit gjykues të çështjes për marrjen e vendimit lidhur me procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula.

17. Nga shqyrtimi i legjislacionit të zbatueshëm në fuqi, trupi gjykues vëren se referuar nenit 55, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, procesverbali i bisedimeve të çështjes mbahet nga personeli i regjistrit të Komisionit, detyrim ligjor ky i cili në rastin konkret, edhe nëse është përmbushur, nuk mund të provohet sa kohë procesverbali nuk është nënshkruar nga punonjësi përgjegjës për mbajtjen e tij.

18. Gjithashtu, referuar nenit 57, pika 3, shkronjat “b” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, në kërkesat e kësaj dispozite lidhur me elementet që duhet të përmbajë vendimi i arsyetuar, përcaktohen edhe ora dhe vendi i vendimit të dhënë, si dhe trupi gjykues që ka shqyrtuar çështjen dhe punonjësi administrativ. Referuar fakteve të konstatuara më sipër, në pjesën hyrëse të vendimit të arsyetuar, janë dhënë data dhe ora e seancës dëgjimore të kryer me subjektin e rivlerësimit dhe jo ajo e shpalljes së vendimit, ndërkohë që në fund të dispozitivit të vendimit thuhet shprehimisht: *Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 4.06.2020* – dhe rezulton të jetë nënshkruar nga sekretarja gjyqësore, ndonëse është vendosur poshtëshënimi që ajo nuk ka qenë prezente.
19. Bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, pikat 2 dhe 6 të tij, të cilat parashikojnë shprehimisht: 2. *Seanca dëgjimore e Komisionit është publike dhe zhvillohet në përputhje me nenin 20 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*. [...] 6. *Vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore* – trupi gjykues vlerëson se pasoja që sjell mungesa e punonjësit administrativ në seancën e shpalljes së vendimit të Komisionit (i titulluar sekretar gjyqësor në aktet e Komisionit), duhet marrë në shqyrtim në kuadër të parashikimeve të ligjit nr. 49/2012⁹ dhe Kodit të Procedurës Civile.
20. Në kuptim të sa më sipër, trupi gjykues konstaton se referuar nenit 77 të Kodit të Procedurës Civile: *Sekretari gjyqësor dokumenton për të gjithë efektet, në rastet dhe në mënyrat e parashikuara nga ligji, veprimtari të mirëfillta të gjykatës, të palëve e pjesëmarrësve të tjerë në proces. Sekretari merr pjesë në të gjitha veprimet e gjykatës për të cilat duhet të mbahet procesverbal [...]*. Bazuar në këtë parashikim ligjor, trupi gjykues çmon se zhvillimi i seancës gjatë së cilës është shpallur vendimi i Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, në mungesë të sekretares gjyqësore, përbën shkelje të rregullave procedurale për zhvillimin e seancës gjyqësore dhe mbajtjes së procesverbalit me shtypshkrim, referuar neneve 77 dhe 118 të Kodit të Procedurës Civile, për më tepër që nuk u provua as ekzistenca e procesverbalit audio të seancës së dhënies së vendimit të Komisionit, në formën dhe përmbajtjen e kërkuar sipas legjislacionit procedural.
21. Për rrjedhojë, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin 51, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, në prani të subjektit të rivlerësimit me qëllim korrigjimin e gabimeve procedurale të kryera nga Komisioni. Në këtë mënyrë, trupi gjykues zgjidhi të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me shkeljet nga ana e Komisionit të parimeve të përgjithshme në kuadër të procesit të rregullt ligjor dhe aspekteve të tjera me natyrë procedurale.

B. Vlerësimi i shkaqeve të tjera të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit nga Komisioni dhe çështje të zbatimit të legjislacionit

22. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”), në drejtim të mosrespektimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe

⁹ Në nenin 1, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, përcaktohet: “Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe”.

e paanshme, për sa kohë i njëjti trup gjykues që ka bërë hetimin administrativ, mbledhjen e provave dhe ngritjen e dyshimeve, i njëjti trup gjykues (me të njëjtët anëtarë) ka dhënë edhe vendimin përfundimtar në rolin e gjyqtarit. Subjekti i rivlerësimit e mbështeti këtë shkak të ankimit në pretendimet e mëposhtme.

22.1. *Në asnjë dispozitë të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, nuk gjendet e parashikuar as në mënyrë të shprehur dhe as të nënkuptuar që duhet të jenë të njëjtët persona ose i njëjti trup gjykues i Komisionit që do të zhvillojë hetimin administrativ dhe do të marrë vendimin përfundimtar ndaj subjektit të rivlerësimit.*

22.2. *GjEDNj-ja, në jurisprudencën e saj, ka theksuar rëndësinë që paraqet parimi i paanësisë së organit publik, një prej elementeve më të rëndësishme të tij është edhe fakti që i njëjti organ ose të njëjtët persona nuk mund të bëjnë pjesë edhe si trupë akuzuese, edhe si trupë vendimmarrëse, në të njëjtën çështje¹⁰. Subjekti pretendoi se për sa kohë vendimi është marrë në shkelje të rëndë të parimit të paanësisë së trupit gjykues, duke cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor, vendimi i Komisionit duhet të konstatohet si absolutisht i pavlefshëm në zbatim të nenit 108, shkronja “a” e Kodit të Procedurave Administrative.*

23. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues rikonfirmoi qëndrimin e mbajtur në vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit, sipas së cilave pretendime të tilla janë gjetur të pabazuara në ligj, me arsyetimin se veprimtaria e trupit gjykues të Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar edhe nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017. Trupi gjykues vëren se në të njëjtin konkluzion për moscenim të nenit 6, pika 1 e KEDNj-së, ka arritur edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen gjyqësore Xhoxhaj kundër Shqipërisë¹¹, në drejtim të vlerësimit të pretendimeve të ngjashme të kërkuases lidhur me cenimin e parimit të gjykatës së paanshme.

24. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, pretendoi se Komisioni ka cenuar të drejtën e saj për proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, pasi vendimi objekt ankimi nuk është marrë nga një gjykatë e caktuar me ligj. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit kërkoi konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, e mbështeti këtë shkak të ankimit të saj në pretendimet e mëposhtme.

24.1. *Komisioni, në gjykimin e çështjes së subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, ka shkelur detyrimin kushtetues të përcaktuar nga neni C, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, sipas së cilës Komisioni përbëhet nga katër trupa gjykues të përhershëm, me tre anëtarë secili. Sipas subjektit të rivlerësimit, shortimi duhet të bëhet vetëm për gjyqtarin relator që do ta shqyrtojë çështjen dhe në këtë mënyrë përcaktohet edhe trupa gjykuese prej tre anëtarësh, me përbërje të përhershme, sipas nenit C të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, pretendoi se nga vendimet e marra në Komision vërehet se anëtarët e të gjithë trupave gjykuese janë ndërruar*

¹⁰ Subjekti ka referuar në këtë kontekst vendimin e GjEDNj-së në çështjen Volkov kundër Ukrainës, si dhe vendimin e GjEDNj-së në çështjen Werner kundër Polonisë.

¹¹ Shih paragrafët 307, 308 dhe 317 të të njëjtit vendim të GjEDNj-së.

e caktuar të ndryshëm, duke mos mbetur asnjë trupë me përbërje me anëtarë të përhershëm. Ajo pretendoi gjithashtu se trupa që e ka gjykuar nuk ka qenë e njëjtë me trupat që kanë kryer gjykimin e subjekteve të tjera, përpara dhe pas çështjes së saj, gjë që, sipas saj, përbën shkelje të Kushtetutës dhe të ligjit. Në këto kushte, sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi nr. 254, datë 04.06.2020, nuk është marrë nga një gjykatë e caktuar me ligj, sipas kërkesave të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së, duke sjellë për pasojë cenimin e parimit për proces të rregullt ligjor.

24.2. Të tre anëtarët e trupit gjykues që kanë rivlerësuar subjektin e rivlerësimit, znj. Entela Shedula, kanë qenë pjesë e listës së parë të kandidatëve që nuk plotësonin kriteret ligjore të zgjedhshmërisë, asnjë prej tyre nuk ka ardhur nga radhët e gjyqësorit, si dhe ka dyshime që ata janë caktuar në detyrë në kundërshtim me përcaktimin e ligjit dhe të Kushtetutës.

25. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues konstatoi se me të drejtë subjekti parashtrori se referuar nenit C, pika 1 e Kushtetutës dhe nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni organizohet dhe shqyrton çështjet e rivlerësimit në 4 trupa gjykues të përhershëm me nga tre anëtarë secili. Megjithatë, pretendimi i subjektit se trupi gjykues përcaktohet nëpërmjet përcaktimit të gjyqtarit relator, vlerësohet se nuk ka mbështetje ligjore, pasi referuar nenit 14, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, fillimisht përcaktohen trupat gjykues, më pas hidhet shorti për ndarjen e çështjeve sipas këtyre trupave gjykues dhe në fund, përcaktohet nëpërmjet shortit se cili anëtar i trupit gjykues, të cilit i është shortuar më parë çështja, do të caktohet si relator i saj.
26. Nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të çështjes objekt gjykimi, rezultoi se trupi gjykues i Komisionit, i ngarkuar me kryerjen e procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Entela Shedula, është caktuar nëpërmjet procedurës së shortit, në datën 15.03.2018 dhe cilësohej si trupi gjykues nr. 3. Referuar vendimit nr. {***} të trupit gjykues nr. 3, të datës 21.03.2018, sipas të cilit, ndër të tjera, rezulton të jetë zgjedhur kryesuesi i trupit gjykues dhe është vendosur fillimi i procedurës së hetimit administrativ, konstatohet se në mbledhjen e Komisionit të datës 15.03.2018, është hedhur shorti për subjektet e listës së përparësive për shkak të ligjit dhe, si pasojë, çështja e subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, është shortuar për t'u shqyrtuar nga trupi gjykues nr. 3, çka lë të kuptohet se më parë janë shortuar trupat gjykues dhe, në vijim, është bërë shpërndarja nëpërmjet shortit e çështjeve të rivlerësimit nëpër trupat gjykues. Kjo procedurë duket të jetë në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.
27. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit si parashtruar në paragrafin 24.2 më sipër, konstatoi se cenimi i parimeve të procesit të rregullt adresohet nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të pretendimit se anëtarët e trupit gjykues të Komisionit nuk plotësojnë kriteret ligjore për të qenë komisionerë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Lidhur me sa më sipër, Kolegji ka krijuar jurisprudencë të konsoliduar ku pretendime të kësaj natyre, lidhur me mospërbushjen e kriteve ligjore për zgjedhshmërinë në detyrë të komisionerëve, i ka vlerësuar si të pabazuara në ligj për t'u ngritur para Kolegjit, duke qenë se tejkalojnë kompetencat juridiksionale të tij. Për rrjedhojë, për sa kohë nuk konstatohen fakte apo rrethana të tjera në drejtim të mosformimit të rregullt të trupit gjykues, që do ta bënin vendimmarrjen e Komisionit të cënueshme në drejtim të pavarësisë apo paanësisë së tij, vlerësuar në kuadër të

rregullave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi dhe jurisprudenca e GjEDNj-së, ky pretendim i subjektit nuk gjendet i bazuar në ligj.

28. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka shkelur parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme pasi: (i) vendimmarrja e Komisionit e bazuar në një kriter, atë të pasurisë, është paragjyqese dhe tërësisht në kundërshtim me nenin Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, si dhe cenon standardet e procesit të rregullt ligjor; (ii) trupi gjykues ka paragjykuar çështjen, duke qenë se është futur në seancë dëgjimore pa lexuar kundërshtimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe duke kërkuar nga subjekti që kundërshtimet t'i paraqiste në mënyrë të përmbledhur, ndërkohë që vetëm në saje të këmbënguljes së subjektit për të dhënë shpjegime në detaj, është vendosur të riçelet hetimi administrativ.
29. Lidhur me pretendimin e subjektit se vendimmarrja e Komisionit mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit vetëm për një kriter përbën paragjykim, trupi gjykues e gjen të pabazuar në ligj këtë shkak. Kjo për faktin se, referuar parashikimeve të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni merr vendim bazuar në një ose disa prej kriterëve të rivlerësimit. Trupi gjykues rikonfirmon qëndrimin e deritanishëm të Kolegjit lidhur me pretendime të ngjashme në çështje të tjera rivlerësimi, sipas të cilit ka arsyetuar se kjo dispozitë, neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vlerësuar në harmoni me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me të cilin Komisioni u kalon barrën e provës subjekteve të rivlerësimit në momentin që ai arrin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë, e ka çuar Kolegjin në përfundimin se vendimmarrja e Komisionit në këto raste, bazuar mbi parashikimet e mësipërme ligjore, nuk është as paragjyqese dhe as e paracaktuar.
30. Ndërsa sa i takon pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka paragjykuar çështjen, duke qenë se është futur në seancë dëgjimore pa lexuar kundërshtimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur ndonjë provë të këtij fakti dhe se referuar akteve të fashikullit të çështjes, është e pamundur të verifikohet një pretendim i tillë. I vetmi argument mbi të cilin subjekti mbështet pretendimin për qëndrim paragjyqes të trupit gjykues të Komisionit, është fakti i riçeljes së hetimit administrativ pas zhvillimit të seancave dëgjimore si referuar edhe në pjesën hyrëse të vendimit objekt kontrolli, fakt ky që në vlerësim të trupit gjykues, dëshmon më shumë në favor të seancave dëgjimore efektive dhe të një procedure vlerësimi të kujdesshme të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe provave të paraqitura prej saj në kuadër të barrës së provës, sesa për një qëndrim paragjyqes të Komisionit. Për rrjedhojë, në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk ngrihet dot në nivelin e një shkakut të ligjshëm për cenimin e vendimit të Komisionit.
31. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka cenuar nenin 8 të KEDNj-së pasi në rastin objekt gjykimi, masa e dhënë për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Sipas subjektit të rivlerësimit, duke pasur parasysh që neni 58 i ligjit nr. 84/2016, përcakton se rezultatet e vetme të mundshme të procesit të verifikimit janë: (a) konfirmimi në detyrë; (b) pezullimi nga detyra për një periudhë njëvjeçare; dhe (c) shkarkimi nga detyra – institucioneve të rivlerësimit u jepet mundësi e kufizuar për të balancuar interesat publike

dhe individualë të konkurruar në dritën e secilit rast individual. Subjekti u shpreh se ndonëse ligji nr. 84/2016 parashikon se gjatë hetimit administrativ duhet të respektohet parimi i proporcionalitetit, ai nuk përmban rregulla, në bazë të së cilave të sigurohet që shkarkimi i subjektit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016, do të zbatohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

32. Në shqyrtim të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerësoi fillimisht se analiza lidhur me respektimin ose jo të parimit të proporcionalitetit në dhënien e masës së shkarkimit të subjektit nga detyra, është objekt kontrolli nga ana e Kolegjit në shqyrtimin e shkaqeve të ankimit që kundërshtojnë konkluzionet e Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, të cilat kanë çuar në marrjen e vendimit për shkarkimin e subjektit. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues çmoi se, sa kohë pretendimi për cenim të nenit 8 të KEDNj-së është trajtuar nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të moszbatimit të parimit të proporcionalitetit në lidhje me masën e shkarkimit nga detyra, si pasojë e kufizimeve që prodhojnë dispozitat e ligjit nr. 84/2016, ky pretendim gjendet i pabazuar në ligj. Ky konkluzion i trupit gjykues mbështetet në faktin që dispozitat e ligjit nr. 84/2016 i janë nënshtruar edhe procesit të kontrollit të kushtetutshmërisë, vlerësuar sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.01.2017. Gjithashtu rezultoi se edhe GjEDNj-ja në vendimin e saj në çështjen Xhoxhaj kundër Shqipërisë, në shqyrtimin e pretendimeve të kërkuases, të ngjashme me këto të subjektit të rivlerësimit, ka vlerësuar se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me masën e shkarkimit nga detyra të kërkuases. GjEDNj-ja është shprehur: *[...] Në të vërtetë, ligji nr. 84/2016 parashikon dy lloje sanksionesh disiplinore: shkarkimin nga detyra ose pezullim me detyrimin për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm. Gjykata ka konsideruar, ndër të tjera, se mungesa e një shkalle të përshtatshme sanksionesh për shkelje disiplinore mund të jetë në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit (shih Oleksandr Volkov, paragrafi 182). Në lidhje me këtë, gjykata duhet të theksojë se ligji për Gjykatën Kushtetuese parashikon një hierarki më të hollësishme sanksionesh disiplinore, siç përshkruhet në paragrafin 200 më lart, i cili vendoset në përfundim të procesit të zakonshëm disiplinor. Sidoqoftë, procesi i rivlerësimit ka natyrë sui generis, me gjithë ngjashmëritë që duket se ka me proceset e zakonshme disiplinore. Ai është miratuar në përgjigje të pranisë së perceptuar të përhapur të korrupsionit në sistemin e drejtësisë, në mënyrë që të largojë elementet e korruptuara dhe të ruajë pjesën e shëndetshme të sistemit. Në rrethanat e jashtëzakonshme që i paraprijnë miratimit të ligjit nr. 84/2016, siç theksohet, gjithashtu, në paragrafët 391, 392 dhe 404 më lart, gjykata konstaton se është në përputhje me frymën e procesit të rivlerësimit që të ketë një shkallë më të kufizuar sanksionesh, në rast se një person nuk arrin të përmbushë një nga tri kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 84/2016. [...].*
33. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka cenuar nenin 14 të KEDNj-së për shkak se prej tij nuk është zbatuar parimi i barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni për subjekte të tjera rivlerësi, të ndodhura në të njëjtën situatë faktike si subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, ka mbajtur qëndrime të ndryshme, duke i konfirmuar në detyrë, ndryshe nga çka vepruar me znj. Shedula.
34. Trupi gjykues konstatoi fillimisht se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është artikuluar në mënyrë sipërfaqësore, pasi nuk rezultoi të jetë argumentuar apo qoftë edhe vetëm evidentuar në

ankim situata e ngjashme faktike dhe trajtimi i ndryshëm ligjor nga ana e Komisionit lidhur me këtë çështje. Pavarësisht kësaj, në vlerësim të trupit gjykues, në çdo rast, një pretendim i tillë i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar nga jurisprudenca e deritanishme.

35. Lidhur me shkakun e ankimit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 1, duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme, si dhe në kundërshtim me parashikimet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur kjo dispozitë ligjore kërkon plotësimin në mënyrë kumulative dhe jo alternative të dy kriterëve: pamjaftueshmërisë në kontrollin e figurës dhe pamjaftueshmërisë në vlerësimin e pasurisë, trupi gjykues sjell në vëmendje se tashmë Kolegji ka krijuar jurisprudencë të konsoliduar në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me raportin e pavarur që kanë këto dy dispozita në prodhimin e pasojës juridike të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Sikundër dhe sa i takon mënyrës së vlerësimit të secilit kriter rivlerësimi (atij të pasurisë dhe pastërtisë së figurës), e cila është e pavarur dhe mund të çojë në mënyrë të pavarur në pasojat e parashikuara nga neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, nëse deklarimi i subjektit për secilin kriter objekt shqyrtimi, vlerësohet i pamjaftueshëm. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në konkluzionin se ky pretendim është i pabazuar në ligj dhe nuk mund të përbëjë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimit të Komisionit në drejtim të sa më sipër.
36. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, në drejtim të kuptimit të konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm. Subjekti pretendoi se deklarimi vlerësohet i pamjaftueshëm nëse përmban një nga situatat e përcaktuara në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të cilat, për sa kohë sjellin të njëjtën pasojë, atë të parashikuar në nenin 61, pika 3 e të njëjtit ligj, që përbën shkak për shkarkimin e subjektit nga detyra, duhet të jenë në të njëjtin nivel rëndësie dhe provueshmërie, si dhe të përbëjnë sjellje të rëndë të subjektit të rivlerësimit të një niveli të njëjtë ose të përafërt. Subjekti qartësoi se, me sa më sipër parashtruar, mungesa e burimeve financiare për të justifikuar pasuritë (pika “b” e pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016) mund të përbëjë deklarim të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit, vetëm nëse është në atë nivel të rëndë shkeljeje, të krahasueshëm ose të barabartë me fshehjen e pasurisë (neni 33, pika 5, germa “c”), deklarimin e rremë (neni 33, pika 5, germa “ç”) ose situatën e konfliktit të interesit (neni 33, pika 5, germa “d”).
37. Lidhur me shkakun e mësipërm të ankimit, i cili ka të bëjë me interpretimin e konceptit të deklarimit të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3, vlerësuar ky në raport me konstatimet e procedurës së vlerësimit të pasurisë sipas nenit 33, pika 5 e të njëjtit ligj, trupi gjykues vëren se jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tilla të subjekteve të rivlerësimit si të pabazuara në ligj, për sa kohë konstatimet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016,

si situata të cilat mund ta vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, nuk vlerësohen në raport me njëra-tjetrën, por shihen si situata të pavarura, vlerësimi i të cilave në kuadër të prodhimit të pasojave të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i nënshtrohet rast pas rasti parimit të proporcionalitetit.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

38. *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “godinë e kombinuar 3-katëshe”, kati përdhes me destinacion social-ekonomik dhe sip. 139,3 m², kati i parë dhe i dytë me destinacion banim dhe sip. 174,9 m² secili, me vendndodhje Kavajë, për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendoi se përfundimi i arritur nga Komisioni është i papabuar, trupi gjykues konstatoi si vijon.*
39. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ndër të tjera, si vijon: **i. Në lidhje me burimet e ligjshme për krijimin e pasurisë** – [...] trupi gjykues ka konkluduar se gjendja negative e rezultuar nga analiza e kryer për vitet 1994 –1999, nuk mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin, me pasojë aplikimin e masës disiplinore. Për vitet 2000 – 2001, referuar analizës financiare, subjekti ka qenë pjesë e familjes Shedula, celebruar në vitin 1999 dhe ka kontribuar financiarisht për ndërtimin e shtëpisë. Për këtë periudhë, nga analiza financiare ka rezultuar mungesë burimesh të ligjshme për investimin në ndërtesën 3-katëshe dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera, në shumën -802.456 lekë. Për vitet 2003 – 2016, referuar analizës financiare, subjekti ka mungesë burimesh të ligjshme në investimin në ndërtesën 3-katëshe dhe për të përballuar shpenzimet, konkretisht, sipas viteve sa më poshtë: për vitin 2006, mungesë burimesh të ligjshme në shumën -1.631.673 lekë; për vitin 2008, mungesë burimesh të ligjshme në shumën -468.122 lekë; për vitin 2012, mungesë burimesh të ligjshme në shumën -255.157 lekë. Komisioni arsyeton se subjekti, me prapësimet dhe provat e paraqitura, nuk provoi bindshëm të ardhurat për krijimin e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasurinë e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë. [...] **iii. Në lidhje me kreditë e Fondit B., të deklaruar si një nga burimet e krijimit të pasurisë** – Komisioni nuk u bind me shpjegimet e dhëna nga subjekti në lidhje me përdorimin e kredive për ndërtimin e shtëpisë, pasi qëllimi i marrjes së tyre ishte për biznes. Kontratave të kredive, nënshkruar nga subjekti dhe bashkëshorti, janë akte ligjore, referuar nenit 690 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të cilat kanë fuqinë e ligjit për palët. Në objektin e kontratave dhe në aktet bashkëlidhur, përcaktohet qartësisht qëllimi i marrjes së këtyre kredive për aktivitet tregtar. **iv. Në lidhje me pronësinë e truallit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004** – nga subjekti është deklaruar shtëpi banimi me kat përdhes, kat të parë dhe kat të dytë karabina, ndërtuar në truall të përfutur me trashëgimi, ndërkohë që nga hetimi i Komisionit, pranuar edhe nga deklarimet e subjektit, rezultoi se përfitimi i kësaj pasurie nuk ishte me trashëgimi, por pasuri/truall që rezulton në emër të shtetit, të konfirmuar edhe nga dokumentacioni gjatë hetimit administrativ. Në lidhje me pronësinë mbi truallin ku është ndërtuar pasuria, subjekti ka parashtruar se kjo është pasuri e trashëguar e familjes Shedula dhe banesa e ndërtuar ndodhet mbi truallin e kthyer me vendim të K.K.K. Pronave nr. {***}, datë 21.4.1994. [...] Nisur nga fakti që trualli mbi të cilin ndodhet godina 3-katëshe, pozicionohet në pasurinë nr. {***} vol. {***}, f. {***}, e cila figuron edhe sot në emër shtetit, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka bërë deklarim të saktë në deklaratën “vetting” dhe atë periodike për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, e cila

*duhet të ishte deklaruar sipas statusit ligjor që ka pasur kjo pasuri, të dokumentuara edhe nga aktet që depozitoi subjekti me vendimin e K.K.K Pronave nr. {***}, datë 21.4.1994 dhe shkresën e ASHK-së Kavajë nr. {***} prot., datë 2.3.2020. v. Në lidhje me kredinë prej 2.000.000 lekësh, marrë në Tirana Bank në vitin 2005 – subjekti kërkoi që kjo shumë të përfshihet në analizën financiare si burim krijimi për ndërtimin e shtëpisë, pasi ka pretenduar se e ka disponuar këtë shumë “cash” në shtëpi. Subjekti, në prapësime, ka shpjeguar se në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, nuk e ka deklaruar si gjendje “cash”, pasi e ka deklaruar si kredi te kapitulli i kredive/detyrimeve financiare dhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, e ka deklaruar, ndër të tjera, edhe si burim për vijimin e punimeve në ndërtesën 3-katëshe. Komisioni, duke analizuar të dhënat e bankës nga momenti i disbursimit të kredisë, ka evidentuar tërheqje në shuma të ndryshme dhe deri në muajin gusht të vitit 2005, kredia ka rezultuar e tërhequr tërësisht. Nisur nga ky fakt, trupi gjykues e ka të vështirë të pranojë pretendimet e subjektit se një pjesë të kredisë e ka disponuar gjendje “cash” në shtëpi dhe në vitin 2006 e ka përdorur për investimet në ndërtesën 3-katëshe. Subjekti nuk ishte bindëse në deklaratimet mbi përdorimin e kredisë në vitin 2006, për vijimin e punimeve në ndërtesën 3-katëshe. Në kuadër të arsytimit të mësipërm, Komisioni është shprehur në vendim se ka arritur në konkluzionin¹²: Për sa më sipër, në lidhje me këtë pasuri, ka rezultuar: mungesë burimesh financiare të ligjshme për investimin në ndërtimin e banesës 3-katëshe, sipas fazave të ndërtimit të deklaruar nga subjekti; deklarim i pasaktë për të ardhurat e deklaruara të bashkëshortit; mospërputhje deklarimesh në lidhje me burimin e krijimit në deklaratën “vetting” me deklarimin periodik të vitit 2003; deklarim i pasaktë në lidhje me truallin, mbi të cilin është ndërtuar godina 3-katëshe.*

40. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar si të pabazuar konkluzionin e Komisionit lidhur me vlerësimin e kësaj pasurie. Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendoi se sa i takon truallit mbi të cilin është ngritur ndërtesa 3-katëshe, konkluzioni i Komisionit për deklarim të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe atë periodike për mënyrën e fitimit të pronësisë së këtij trualli, është i pabazuar në fakte. Subjekti pretendoi se Komisioni ka arritur në konkluzion të gabuar se nga aktet, është njohur e drejta e pronësisë mbi truallin, por kjo pronë nuk u është kthyer pronarëve, pasi ka interpretuar në mënyrë të gabuar vendimin nr. {***}, datë 21.04.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim “KKKP”). Subjekti pretendoi se në vendimin e KKKP-së nr. {***}, datë 21.04.1994, është vendosur: *Të njohë pronësinë e truallit me sipërfaqe 3608 m² të katër trashëgimtarëve, sipas dëshirës, nga 1/4 pjesë secili, dhe t’u kthejë sipërfaqen 2400 m², ndërsa sipërfaqen prej 1208 m², ata e disponojnë dhe të bëhet kalimi i pronësisë te katër trashëgimtarët.*
41. Në kontekst të sa më sipër, subjekti shpjegoi se referuar këtij vendimi, sipërfaqja prej 1208 m², në të cilën është ngritur ndërtesa 3-katëshe, është poseduar *de facto* nga familja Shedula. Referuar shkresës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim “AShK”), Drejtoria Vendore Kavajë, nr. {***} prot., datë 06.03.2020, në të cilën është bërë pozicionimi i banesës 3-katëshe të legalizuar në hartën kadastrale të AShK Kavajë, sipas regjistrimit fillestar të vendndodhjes së pronës së kthyer me vendimin e KKKP-së nr. {***}, datë 21.04.1994, rezulton se kjo banesë ndodhet mbi truallin e kthyer me vendimin e sipërcituar. Subjekti pretendoi se, ndodhur në këto kushte, mosregjistrimi pranë AShK-së i pasurisë së paluajtshme të trashëgimtarëve Shedula, mbi të cilën është ndërtuar banesa 3-katëshe e legalizuar, nuk e bën të pavlefshëm vendimin e KKKP-së nr. {***}, datë 21.04.1994, por nuk u jep mundësinë bashkëpronarëve për ta tjetërsuar atë të tretët¹³.

¹² Shih paragrafin e dytë në faqen 12 të vendimit të Komisionit.

¹³ Subjekti referon këtu edhe vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1/2009.

42. Ndërkohë që, sa i takon konkluzionit për deklaram të pamjaftueshëm të kësaj pasurie në drejtim të mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e saj, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi si të gabuar analizën financiare të Komisionit të kryer për këtë qëllim, në drejtim të:

(i) Vlerësimit të kredive të marra pranë Fondacionit B. në vitet 2000-2001. Subjekti pretendoi se përdorimin e kredive të marra nga Fondacioni B. e ka deklaruar si burim për ndërtimin e banesës 3-katëshe në deklaratat periodike vjetore (në vijim “DIPPV”) të viteve 2003 dhe 2004, dhe kërkoi nga Kolegji që këto deklarime periodike t’i vlerësojë si provë. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, argumentoi se provë të faktit që kreditë e marra për arsye biznesi nga bashkëshorti i saj janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve të ndërtimit, përbëjnë edhe të dhënat e bilancit të personit fizik F. Sh., me NIPT {***}, nga ku konstatohet se jo vetëm që këto kredi nuk janë përdorur për qëllime të aktivitetit tregtar të ushtuar prej tij, por edhe që z. F. Sh. ka tërhequr vlera monetare nga personi fizik, në total prej 1.485.090 lekësh, në periudhën e viteve 2000-2001, evidentuar në bilancet e personit fizik, në zërin “vlera arkë ose të tjera/llog. 108 pronari”, çka tregon se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të mbuluar shpenzimet dhe investimet e kryera gjatë kësaj periudhe.

(ii) Moskonsiderimit si burim të ligjshëm të përdorimit në vitin 2006 të një pjese të kredisë së marrë pranë Bankës Tirana në vitin 2005, në vlerën e 2.000.0000 lekëve. Subjekti pranoi se në DIPPV-në e vitit 2005, nuk e ka deklaruar gjendjen *cash* të mbetur pas tërheqjes së kredisë në gusht të të njëjtit vit, por pretendoi se faktin e ekzistencës së këtij likuiditeti *cash* e ka saktësuar në DIPPV-në e vitit 2006, teksa ka deklaruar qëllimin për të cilin ka marrë këtë kredi, si dhe deklaramin si burim për investimin e katit të tretë të ndërtesës të një pjese prej 1.250.000 lekësh të kësaj kredie. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, pretendoi se pasaktësia e saj në DIPPV-në e vitit 2005, në mosdeklaramin në formën e likuiditetit në gjendje *cash* të pjesës së mbetur nga kredia e marrë në vitin 2005, ka ndodhur për shkak se bëhej fjalë për vitet e para të deklaramit, ku dhe parashikimet ligjore në fuqi në atë kohë, merrnin parasysh ekzistencën e pasaktësive dhe vetëm kur kaloheshin pragjet ligjore¹⁴, pasuritë mund të konsideroheshin me burime të paligjshme. Subjekti argumentoi se duke qenë se nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, si dhe qëndrimi i mbajtur në vendim, viti 2005 rezulton me tepriçë pozitive në shumën 1.628.822 lekë, e cila është pothuajse e njëjtë me diferencën negative që nxjerr Komisioni në vitin 2006, kjo e dhënë në unitet me argumentet e mësipërme, sipas subjektit, duhet të kishte bindur Komisionin që deklaramet e saj janë të vërteta dhe mosdeklarami i gjendjes *cash* në vitin 2005 është pasaktësi e rregulluar në vitin 2006¹⁵.

(iii) Vlerësimit të gabuar të të ardhurave të realizuara nga paga e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. F. Sh., si i punësuar pranë shoqërisë “{***}” ShPK, për vitin 2008. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, pretendoi se bashkëshorti i saj i ka përfituar pagat në vlerën e tyre neto dhe ai nuk ka pasur dijeni për mospagimin e shumave të mbajtura nga paga nga punëdhënësi si agjent tatimor, në kuadër të detyrimeve që i burojnë këtij të fundit për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore, si dhe të tatimit mbi të ardhurat nga paga.

¹⁴ Subjekti referon këtu nenin 28 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, të ndryshuar deri në periudhën objekt vlerësimi (viti 2006), sipas të cilit parashikohej: “Kur edhe nga procedurat e përcaktuara në nenin 27, nuk mund të justifikohen me burime të ligjshme pasuritë e krijuara dhe kur këto mospërputhje janë mbi 2.000.000 lekë për deklaramet vjetore dhe mbi 3.000.000 lekë për deklaramet sipas neneve 6 dhe 9 të këtij ligji, atëherë vlerësohet se pasuritë janë krijuar në mënyrë të paligjshme dhe Inspektori i Përgjithshëm njofton menjëherë prokurorinë”.

¹⁵ Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, referon në mbështetje të argumentimit të saj edhe qëndrimin e mbajtur nga Kolegji në vendimin e tij nr. {***}, datë 31.07.2019.

(iv) Përlllogaritjes së vlerës totale të investimit për ndërtimin e banesës 3-katëshe. Subjekti pretendoi se vlera totale e investimit të kryer, e deklaruar prej saj në deklaratën e pasurisë *vetting*, është 8.450.000 lekë dhe jo aq sa është përlllogaritur nga ana e Komisionit, 10.830.192 lekë. Subjekti pretendoi se Komisioni nuk ka marrë parasysh faktin që ky ndërtim është kryer në mënyrë informale, për rrjedhojë konkluzioni i Komisionit për deklaram të pasaktë, është i gabuar. Subjekti pretendoi gjithashtu se llogaritjet e kryera nga Komisioni për vlerën e investimit të kryer në vitet 1995-1999, janë të pasakta pasi janë rrjedhojë e prodhimit të sipërfaqes së ndërtimit me vlerën e kostos/m² që i takon sipërfaqes së shfrytëzimit dhe jo asaj të ndërtimit. Sipas subjektit, një tjetër element që ka ndikuar në analizën e Komisionit, është edhe fakti që në përlllogaritjet e Komisionit, kati i dytë i ndërtesës është llogaritur në vitin 1999 sikur të ishte i përfunduar, ndërkohë që në atë periudhë kati i dytë ka qenë ndërtuar vetëm si karabina.

43. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, duke marrë në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin e Komisionit dhe arsyetimin e këtij të fundit në vendim, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

(i) *Në lidhje me statusin juridik të tokës truall mbi të cilën është ndërtuar godina 3-katëshe*

44. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për konkluzion të gabuar të Komisionit për deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe atë periodike për mënyrën e fitimit të pronësisë së truallit mbi të cilin është ngritur ndërtesa 3-katëshe, referuar akteve të fashikullit të çështjes, lidhur me pronësinë e këtij trualli dhe deklarimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, si dhe qëndrimin të mbajtur gjatë procedurës së hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vëren se:

44.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Pasuria me nr. {***}, ndodhur në z.k {***}, e llojit ndërtesë me sipërfaqe ndërtimi 139,3 m², e përbërë godinë e kombinuar 3KT. Kati përdhe social ekonomik 139,3 m², kati i parë 174,9 m², kati i dytë 174,9 m². Fituar me leje legalizimi nr. {***}, datë 31.03.2016, regjistruar në ZVRPP Kavajë.*

44.2. Në deklaratën periodike të vitit 2016, vit në të cilin është legalizuar ndërtesa dhe është kryer regjistrimi i lejes së legalizimit në ZVRPP Kavajë, subjekti ka deklaruar: *Pasuria me nr. {***}, ndodhur në z.k {***}, e llojit ndërtesë me sipërfaqe ndërtimi 139,3 m², e përbërë godinë e kombinuar 3KT. Kati përdhe social ekonomik 139,3 m², kati i parë 174,9 m², kati i dytë 174,9 m². Fituar me leje legalizimi nr. {***}, datë 31.03.2016, regjistruar në ZVRPP Kavajë (e deklaruar dhe më parë, por regjistruar në vitin 2016).*

44.3. Ndërsa në deklaratën periodike për herë të parë në vitin 2004, deklarimi lidhur me godinën 3-katëshe në ndërtim e sipër, pa leje ndërtimi, është kryer nga z. K. Sh., vjehri i subjektit të rivlerësimit. Ai rezultoi të jetë shprehur: *Shtëpi banimi me kat përdhe, sipërfaqe 150 m² çdo kat, kati i parë i përfunduar, kati i dytë karabina, trualli i përfitur me trashëgimi.*

44.4. Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ nga ALUIZNI, rezultoi se në praktikën e legalizimit të kësaj ndërtesë, në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit më datë 12.09.2006, në rubrikën për dhënie informacioni mbi pronën mbi të cilën është ndërtuar objekti, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka plotësuar me kryq në krah të referimit *pronë private* përkundrejt asaj *publike*. Pjesë e kësaj praktike ishte edhe një komunikim mes ALUIZNI-t dhe ZVRPP Kavajë, ku kjo e fundit, në përgjigje të kërkesës së ALUIZNI-t për efekt të procedurave për dhënie e lejes së legalizimit, ishte shprehur¹⁶:

¹⁶ *Nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 04.04.2016.*

Në përgjigje të shkresës suaj nr. {***} prot., datë 23.03.2016, administruar në ZVRPP Kavajë me nr. {***} prot., datë 25.03.2016, “Për vënien në dispozicion të statusit juridik të pronësisë së truallit, me qëllim legalizimin e objektit informal”, ju informojmë si më poshtë: Parcela ndërtimore që tregohet në fragmentin e hartës, e konturuar me të kuqe bashkëngjitur shkresës suaj, mbi të cilën është ngritur ndërtimi informal i poseduar nga z. F. K. Sh., përfshin pasurinë me nr. {***} që ndodhet në ZK {***}. Pasuria {***} është e llojit truall me sip. 411 m², në emër të **K. Sh.**. Referuar librit të ngastrave të bllokut nr. {***}, të ZK {***}, qyteti Kavajë, pasuria e mësipërme nuk është e regjistruar. Theksojmë se çdo informacion i marrë nga libri i ngastrave, në kuptim të ligjit nr. 33, datë 21.03.2012, nuk përbën dokument ligjor.

44.5. Në datën 03.03.2020, në përgjigje të pyetjeve të Komisionit, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, e pyetur lidhur me statusin ligjor të truallit mbi të cilin është ndërtuar shtëpia 3-katëshe, është përgjigjur: *Lidhur me statusin ligjor të truallit mbi të cilin është ndërtuar shtëpia 3-katëshe, i jam drejtuar AShK-së, Drejtorisë Vendore Kavajë, e cila më ka kthyer përgjigje me shkresën nr. {***} prot., datë 02.03.2020. Bashkëngjitur dokumentacionit, përgjigje nr. {***}, datë 10.10.2019. Kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 02.03.2020. Vendimi nr. {***}, datë 21.IV.1994, i KKK Pronave, fletë shoqëruese, kartelë e pasurisë së paluajtshme, skicë.*

44.6. Referuar shkresës së Drejtorisë Vendore Kavajë të AShK-së me nr. {***} prot., datë 02.03.2020, kjo e fundit është shprehur: *Në vijim të shkresës suaj [...] ju njoftojmë se leja e legalizimit nr. {***} është regjistruar me nr. pasurie {***}, vol. {***}, f. {***}, në emër **Shtet**. Nga verifikimet e kryera, rezulton se me Vendimin e Komisionit të Kthim Kompensimit të Pronave nr. {***}, datë 21.04.1994, është njohur e drejta e pronësisë për sipërfaqen 3608 m², në të cilën pozicionohet ndërtesa e legalizuar. Bashkëlidhur skica e pronësisë, si dhe vendimi i sipërcituar.*

44.7. Referuar vendimit nr. {***}, datë 21.04.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ky i fundit, pasi mori në shqyrtim dosjen nr. {***}, dt. 21.12.1993, të paraqitur nga trashëgimtarët e M. dhe M. Sh., ndër ta dhe K. Sh. (vjehtëri i subjektit të rivlerësimit), të cilët kërkuan njohjen dhe kthimin e pronës së tyre, të një trualli të ndodhur në lagjen “{***}”, me sipërfaqe totale 3608 m², nga të cilat 1208 m² i disponojnë vetë, ndërsa 2400 m² u ishin shpronësuar, vendosi: *Të njohë pronësinë e truallit me sipërfaqe 3608 m² të katër trashëgimtarëve, sipas dëshirës së trashëgimtarëve, nga ¼ pjesë secilit dhe t’i kthejë sipërfaqen 2400 m², ndërsa sipërfaqen prej 1208 m², ata e disponojnë dhe të bëhet kalimi i pronësisë të katër trashëgimtarëve.*

44.8. Bashkëlidhur shkresës së sipërcituar të Drejtorisë Vendore Kavajë, rezultoi dhe një kopje e pacertifikuar kartele e pasurisë së paluajtshme nr. {***} të llojit truall, sipas së cilës kjo pasuri ishte e regjistruar në emrin “Shtet”, me datë regjistrimi 30.05.2018.

44.9. Në prapësimet e saj të datës 09.03.2020, ndaj rezultateve të hetimit shtesë të Komisionit, subjekti ka depozituar një tjetër shkresë nga AShK-ja, Drejtoria Vendore Kavajë¹⁷, në të cilën referohej: *Në vijim të shkresës suaj [...], bashkëlidhur po ju dërgojmë hartën kadastrale të AShK Kavajë, sipas regjistrimit fillestar të vendndodhjes së pronës së kthyer me vendimin e Komisionit të Kthim Kompensimit të Pronave nr. {***}, datë 21.04.1994, duke bërë pozicionimin e banesës 3 kate, të legalizuar me lejen nr. {***}, datë 31.03.2016. Sipas skicës, vërtetojmë se kjo banesë ndodhet mbi truallin e kthyer me vendimin e sipërcituar.*

45. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka bërë deklarametë të cilat nuk përputhen me dokumentacionin justifikues të pasurisë së

¹⁷ Me nr. {***} prot., datë 06.03.2020.

paluajtshme të llojit “godinë e kombinuar 3-katëshe”. I vetmi deklaram i cili lidhet me statusin juridik të pronës, rezulton të jetë bërë nga vjehri i subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, në deklaramin e saj për herë të parë si subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së në vitin 2004. Ky deklaram i z. K. Sh., se trualli mbi të cilin është ngritur ndërtesa 3-katëshe është pronë e trashëguar, provohet nga dokumentacioni ligjor me të cilin është bërë njohja dhe kthimi i pronës “truall me sipërfaqe 3608 m²” në cilësinë e trashëgimtarëve të z. M. dhe M. Sh. (prindërit e vjehrit të subjektit të rivlerësimit), konkretisht me anë të vendimit nr. {***}, datë 21.04.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

46. Trupi gjykues vëren se Komisioni nuk rezultoi të ketë pasur gjetje në drejtim të dijenisë së subjektit të rivlerësimit se pasuria mbi të cilën ishte ngritur ndërtesa 3-katëshe të ketë qenë e regjistruar në emër “Shtet” dhe qëllimisht të mos e ketë deklaruar këtë fakt. Dijenia e subjektit të rivlerësimit nuk mund të mbështetet në argumentin se dokumentacioni që provon se ende sot kjo pasuri është e regjistruar në emër të shtetit, është përcjellë nga vetë subjekti, kur konstatohet se ky dokumentacion është lëshuar nga institucionet kompetente pas datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë *vetting* nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe është bërë me kërkesë të saj në kuadër të dhënies së përgjigjeve të drejtuara nga Komisioni, si dhe në kuadër të barrës së provës që vetë Komisioni i ka kaluar subjektit lidhur me këtë çështje.
47. Përveç sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se ndonëse konstatohet një lloj paqartësie se përse nuk është regjistruar kalimi i pronësisë së gjithë parcelës prej 3608 m², të njohur dhe kthyer me vendimin e sipërcituar të KKKPT-së, në emër të trashëgimtarëve Shedula, nga asnjë prej konfirmimeve zyrtare të marra nga institucionet kompetente, nuk ka dyshim që sipërfaqja e truallit mbi të cilin është ndërtuar objekti 3-katësh, është pjesë e parcelës në pronësi të tyre, por ende e paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Për rrjedhojë të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se kjo situatë e paqartë në drejtim të veprimeve për regjistrimin e titujve të pronësisë pranë ZVRPP Kavajë, nuk sjell ndonjë implikim për subjektin e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit. Kjo, për sa kohë u provua se origjina e pasurisë tokë truall mbi të cilën është ngritur ndërtimi 3-katësh, i legalizuar, rrjedh nga një akt i Komisionit të Kthimit Kompensimit të Pronave, i nxjerrë në bazë të parashikimeve ligjore të kohës, në vitin 1994 dhe se, nga hetimi i kryer nga Komisioni, nuk është ngritur asnjë dyshim për përfshirje të paligjshme të subjektit të rivlerësimit në këtë proces.

(ii) Në lidhje me vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë së paluajtshme të llojit “godinë e kombinuar 3-katëshe”

48. Në kuadër të analizës lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme për ndërtimin e pasurisë “godinë e kombinuar 3 kate”, trupi gjykues çmoi fillimisht të marrë në analizë pretendimet e subjektit në drejtim të përcaktimit të vlerës së objektit. Në këtë kontekst, lidhur me pretendimin për përlllogaritje të gabuar nga ana e Komisionit të vlerës së investimit në objektin 3-katësh, në drejtim të faktit se ndërtimi i kryer është ndërtim informal dhe, si pasojë, ka kosto më të ulët se ndërtimet e rregullta që i nënshtrohen legjislacionit në fushën e ndërtimit, në dritën edhe të vendimmarrjeve më të fundit të Kolegjit, trupi gjykues vlerësoi se në kushtet kur subjektet e rivlerësimit kanë kryer ndërtime për të cilat nuk mund të provojnë me dokumentacion justifikues (situacione punimesh, fatura tatimore etj.) vlerën e shpenzuar për kryerjen e këtij investimi, vlera e objektit në kuptim të koston së tij, do të përcaktohet mbi bazën e çmimeve për metër katror sipas vlerave të miratuara nga EKB-ja, sipas viteve në të cilat është deklaruar dhe/ose është kryer ndërtimi objekt kontrolli.

49. Pretendimet e subjektit për zbritje të komponentëve që lidhen me koston e krahut të punës, faktin që ndërtimi është informal dhe nuk është kryer nga shoqëri ndërtimi apo kosto e materialeve nuk i është nënshtruar TVSh-së etj., janë gjetur të pabazuara, sa kohë subjektet nuk provojnë se kostoja e secilit komponent të pretenduar u ka kushtuar më lirë sesa përlllogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar nga EKB-ja¹⁸. Në këtë kuptim, trupi gjykues çmoi se kontrolli i mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive në pronësi të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta, në rastin kur për këto pasuri nuk ka dokumentacion justifikues lidhur me koston e ndërtimit, do të kryhet mbi bazën e vlerësimit të koston së objektit sipas çmimeve të EKB-së. Për rrjedhojë, në analizën financiare të Komisionit, me të drejtë, është marrë në konsideratë vlera e objektit mbi bazën e llogaritjeve sipas EKB-së.

50. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se llogaritjet e kryera nga Komisioni për vlerën e investimit të kryer në vitet 1995-1999, janë të pasakta pasi janë rrjedhojë e prodhimit të sipërfaqes së ndërtimit me vlerën e koston/m², që i takon sipërfaqes së shfrytëzimit dhe jo asaj të ndërtimit, nga verifikimet e kryera nga trupi gjykues nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, u konstatua se:

50.1. Komisioni ka përlllogaritur si vlerë investimi për ndërtimin e kryer sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit (kati përdhe dhe karabina e katit të parë) në periudhën e viteve 1995-1999, shumën prej 5.606.879 lekësh. Komisioni nuk ka treguar në vendim mënyrën sesi e ka përlllogaritur vlerën e sipërcituar as në drejtim të raportit që ka marrë si bazë për vlerësimin e volumit të punës të kryer për katin në gjendje karabinaje në raport me ndërtimin e plotë të tij, as në drejtim të çmimit mesatar të përdorur për efekt të përlllogaritjeve të kryera.

50.2. Nga përlllogaritjet e kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, rezultoi se për ndërtimin e plotë të katit përdhe dhe të katit të parë, referuar çmimit mesatar për m² sipërfaqe ndërtimi sipas EKB-së¹⁹, për periudhën e viteve 1995-1999, kostoja e ndërtimit do të kapte vlerën e 5.111.719 lekëve²⁰, vlerë kjo e cila, ndonëse i referohet një ndërtimi të dy kateve të plota, është dukshëm më e ulët se vlera e përlllogaritur nga Komisioni.

51. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues arrin në konkluzionin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për përlllogaritje të gabuar të Komisionit për vlerën e investimit të kryer në periudhën e viteve 1995-1999, gjendet i drejtë dhe i bazuar, sa kohë rezultoi se përlllogaritjet e kryera nga Komisioni nuk përkojnë me koston e ndërtimit të kryer sipas çmimit mesatar për m² sipërfaqe ndërtimi. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues çmon se kjo përlllogaritje e gabuar e Komisionit nuk afekton analizën e kryer nga Komisioni për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme, për sa kohë subjektit të rivlerësimit nuk i është atribuar nga Komisioni ndonjë pasojë ligjore lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të bashkëshortit, z. F. Sh., për kryerjen e këtij investimi, i cili rezultoi nga hetimi të jetë në një periudhë gjatë së cilës ky i fundit nuk gëzonte as statusin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, as statusin e personit të lidhur sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar. Për rrjedhojë, konkluzioni i

¹⁸ Shih vendimin e Kolegjit nr. 34/2021, që i përket subjektit të rivlerësimit I.Sh.

¹⁹ Çmimi (lekë/m²) për sip. ndërtimi për vitin 1995, në vlerën 13.851 lekë; çmimi (lekë/m²) për sip. ndërtimi për vitin 1996, në vlerën 13.985 lekë; çmimi (lekë/m²) për sip. ndërtimi për vitin 1997, në vlerën 13.985 lekë; çmimi (lekë/m²) për sip. ndërtimi për vitin 1998, në vlerën 19.762 lekë; çmimi (lekë/m²) për sip. ndërtimi për vitin 1999, në vlerën 19.762 lekë. Çmimi mesatar (lekë/m²) për sip. ndërtimi për periudhën 1995-1999 (13.851 lekë + 13.985 lekë + 13.985 lekë + 19.762 lekë + 19.762 lekë ÷ 5 vjet = 16.269 lekë.

²⁰ Referuar sa më sipër, është përlllogaritur (139,3 m² kati përdhe + 174,9 m² kati parë) x 16.269 lekë/m² çmimi mesatar i periudhës 1995-1999 = 5.111.719 lekë.

mësipërm lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përllogaritje të gabuar të vlerës së “godinës së kombinuar 3 kate”, çmohet pa efekt në zgjidhjen e çështjes.

52. Në përfundim, sa i takon vlerësimit të saktësisë së deklaramit të subjektit në lidhje me vlerën e objektit, përveç sa konkluduar më sipër në lidhje me vlerën e investimit për periudhën 1995-1999, trupi gjykues çmoi se në rastet kur gjatë hetimit administrativ nuk është administruar dokumentacion me vlerë provuese në lidhje me vlerën e objektit, subjekti nuk mund të penalizohet për deklaramit të pasaktë, vetëm mbi bazë krahasimi të vlerës së deklaruar me atë që rezulton nga vlerësimi sipas përllogaritjes së kostos së objektit sipas çmimeve të EKB-së, pavarësisht se, sikundër u shpjegua më sipër, verifikimi i mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme do të vlerësohet mbi bazën e standardit të kostos së ndërtimit të përcaktuar nga EKB-ja.

53. Sa i takon analizës lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme për ndërtimin e godinës objekt kontrolli, duke marrë fillimisht në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të vlerësimit të kredive të marra nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe bashkëshorti i saj pranë Fondacionit B., trupi gjykues, pasi verifikoi dokumentacionin justifikues të dorëzuar bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, në mbështetje të deklaramit të këtyre kredive si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli, si dhe pasi i krahasoi ato me dokumentacionin e përcjellë nga subjekti kredidhënës, konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kishin hyrë në marrëdhënie me Fondacionin B. sipas kontratave të mëposhtme.

53.1. Më datë 16.10.2000, midis Fondacionit B., në cilësinë e huadhënësit, dhe subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, në cilësinë e huamarrëses, është lidhur një kontratë huaje për shumën 300.000 lekë, me një interes prej 24% në vit, për një periudhë 12-mujore. Sipas nenit 7 të kësaj kontrate, huamarrësi angazhohet të përdorë kredinë në aktivitetin ekonomik “Tregti mallra industriale”. Referuar nenit 9 të së njëjtës kontratë, si titull garancie për shlyerjen e kredisë, parashikohet garanci me hipotekë mbi një shtëpi dykatëshe, e ndodhur në lagjen nr. {***}, Kavajë, në pronësi të vjehrrit të subjektit të rivlerësimit, z. K. M. Sh..

53.2. Më datë 28.03.2001, midis të njëjtave palë ishte lidhur një kontratë e titulluar “Kontratë hipotekimi”, por me objekt të përcaktuar në nenin 1 të saj: *Huadhënësi (Fondacioni B.) i jep hua znj. Entela Sorra shumën prej 600.000 lekësh, me një interes prej 24% në vit, për një periudhë 24-mujore*. Referuar nenit 7 të kësaj kontrate, huamarrësi angazhohet ta përdorë kredinë në aktivitetin ekonomik “Tregti konfeksione”. Në bazë të nenit 9, kjo hua/kredi është siguruar me garanci hipotekore mbi pasurinë e paluajtshme si më sipër cituar, në pronësi të vjehrrit të subjektit të rivlerësimit.

53.3. Të njëjtat kontrata me sa më sipër referuar, me të njëjtin objekt, për të njëjtat vlera monetare, me të njëjtin qëllim përdorimi dhe të siguruara me hipotekë mbi pasurinë e paluajtshme në pronësi të z. K. Sh., janë lidhur në të njëjtat data me sa më sipër referuar edhe mes Fondacionit B., në cilësinë e huadhënësit, dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. F. Sh., në cilësinë e huamarrësit.

54. Në total, vlera e marrë hua/kredi nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj pranë Fondacionit “B.” arrinte shumën e 1.800.000 lekëve, vlerë kjo e cila në deklaratën për herë të parë pranë ILDKPKI-së ishte deklaruar nga vjehrrit i subjektit të rivlerësimit si një ndër burimet për ndërtimin e godinës 3-katëshe. Këtë deklaramit të z. K. Sh. e ka konfirmuar në deklaratën e pasurisë *vetting* edhe subjekti i rivlerësimit, teksa i ka deklaruar këto kredi si të përdorura për ndërtimin e banesës 3-katëshe, si dhe gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision dhe gjykimit të çështjes në

Kolegj, subjekti ka qenë konsekuente në deklarimin se këto kredi kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë objekt kontrolli. Më konkretisht, trupi gjykues vëren se:

54.1. Në pyetësoin shtesë të datës 28.10.2019, subjekti teksa është pyetur për qëllimin e marrjes së këtyre kredive, është shprehur: *Kredia nga unë është marrë për familjarin F. Sh., duke qenë se Fondi B. nuk jepte për herë të parë më shumë se 300.000 lekë dhe kredia e dytë nuk jepej më shumë se 600.000 lekë. Në vitin 2000-2001, Fondi B. nuk jepte kredi për ndërtim shtëpie, politika e Fondit B. ishte dhënia e kredisë për aktivitet privat, ndaj bashkëshorti im ishte i detyruar ta merrte kredinë për biznes, e cila u përdor për ndërtimin e shtëpisë. Në vitet 2000-2001, Fondi B. ishte i vetmi institucion i cili jepte kredi pasi Banka e Kursimeve ishte në prag privatizimi dhe nuk jepte kredi.*

54.2. Gjithashtu, në shpjegimet e dhëna në kuadër të barrës së provës që i ka kaluar Komisioni me rezultatet e hetimit të datës 20.11.2019, mbi gjetjen e Komisionit për mospërputhje të deklarimeve për kreditë e marra pranë Fondacionit B., subjekti ka dhënë këto shpjegime: *Deklaroj me përgjegjësi se fondet e marra kredi në Fondacionin B. gjatë viteve 2000-2001, janë përdorur për vazhdimin e punimeve të shtëpisë, e cila tashmë është tri kate. [...] Siç kam deklaruar edhe gjatë shpjegimeve të mia të mëparshme, kam filluar të bashkëjetoj realisht me bashkëshortin në fillim të vitit 2001 dhe, për këtë arsye, në vitet 2000 dhe 2001, kemi pasur nevojë të rregullonim shtëpinë ku do të banonim dhe do të krijojmë familjen e re. Nuk kemi pasur mundësi tjetër financiare, për të mbuluar të gjitha shpenzimet e nevojshme të ndërtimit të banesës në këto vite, përveçse të merrnim një kredi. Në këto vite, Banka e Kursimeve, si e vetmja bankë kursimi që ekzistonte, gjendej në proces privatizimi dhe Fondacioni B., sipas statutit të tij²¹, jepte kredi vetëm për biznese. Për këtë arsye, meqenëse bashkëshorti kishte biznes, nënshkruam kontrata për marrjen e kredisë ku pasqyrohej dhe fakti që fondet do t'i përdornim për biznesin e bashkëshortit, por realisht këto fonde u përdorën për ndërtimin e shtëpisë [...].*

54.3. Të njëjtat deklarime janë ripohuar gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj.

55. Në kuadër të verifikimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me qëllimin real të marrjes së këtyre kredive, trupi gjykues mori në analizë edhe bilancet e personit fizik F. Sh. me NUIS {***} për vitet 2000 dhe 2001, nga ku konstatoi se në zërin “Detyrime- shteti-tatime dhe taksa (TVSh)”, për vitin 2000 paraqitet shuma prej 148.281 lekësh, ndërsa për vitin 2001 shuma prej 15.549 lekësh. Gjithashtu, nga verifikimi i kryer nga trupi gjykues nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, u konstatua se në pasivin e bilancit, zëri “Detyrime të kërkueshme deri në një vit - hua nga bankat dhe institucionet e kreditit”, paraqitet me vlerë zero, çka nënkupton se nuk ka ndonjë shumë të paraqitur në bilance për të dyja vitet në lidhje me këtë lloj detyrimi.

²¹ Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, së bashku me shpjegimet e saj ka dorëzuar në cilësinë e provës dhe disa akte të cilat lidhen me themelimin, regjistrimin dhe statutin e Fondacionit B. (sot Fondi B.). Në nenin 6 të aktit të themelimit të Fondacionit B., përcaktohet shprehimisht: “Qëllimi i Fondacionit është që të nxisë dhe të mbështesë ndërmarrjet e vogla dhe shumë të vogla në Shqipëri (më poshtë “ndërmarrje”) të krijojë vende pune, si dhe të stimulojë vetëpunësimin. Në lidhje me këtë, Fondacioni:

a. do të sigurojë e japë asistencë teknike ndërmarrjeve, në përputhje me praktikën e miradministrimit të biznesit;
b. do të bëjë financime të këtyre ndërmarrjeve sipas kushteve mbizotëruese të tregut;
c. do të kryejë aktivitete të tjera të cilat janë në përputhje me qëllimin kryesor të Fondacionit dhe që janë aprovuar nga Bordi i Drejtorëve”.

Qëllimi i krijimit të Fondacionit B. si më sipër cituar, përmendet shprehimisht edhe në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 01.10.199, për regjistrimin si person juridik të këtij fondacioni. Gjithashtu, në nenin 6 të statutit të këtij fondacioni, përcaktohet: “Fondacioni po ngrihet me qëllimin që të nxisë ndërmarrjet private mikro dhe të vogla, duke përfshirë individë të vetëpunësuar që operojnë në aktivitete ekonomike të shkallës së ulët (së bashku “NMV”) në Shqipëri, të krijojë vende pune si dhe të [...] vetëpunësimin. Në lidhje me këtë, Fondacioni: [...] do të bëjë financime të NMV-së sipas kushteve mbizotëruese të tregut [...].

56. Nga vlerësimi i të dhënave të konstatuara si më sipër, kuptohet se të vetmet detyrime të paraqitura në bilanci e viteve 2000 dhe 2001, janë ato për TVSh-në, çka konfirmon faktin se gjatë këtyre dy viteve financiare, nuk janë gjeneruar detyrime të tjera në emër të personit fizik, situatë kjo e ndryshme me rastin kur kreditë e marra pranë Fondacionit B. do të ishin përdorur për nevoja të personit fizik. Për rrjedhojë, referuar këtyre dy dokumenteve të dorëzuara pranë organit tatimor në përmbushje të detyrimeve ligjore që u lindin personave fizikë që ushtrojnë aktivitet tregtar, shlyerja e detyrimeve për kredinë nuk rezulton të jetë pasqyruar si detyrim i personit fizik. Në një interpretim logjik të fakteve të konstatuara si më sipër, trupi gjykues çmon se për sa kohë shlyerja e detyrimeve për kreditë e marra pranë Fondacionit B., në vlerën respektivisht të 600.000 lekëve për vitin 2000 dhe 1.200.000 lekëve për vitin 2001, nuk është përballuar nga personi fizik, fondet e këtyre kredive nuk duhet të jenë përdorur për nevojat e aktivitetit tregtar të personit fizik F. Sh., me NUIS {***}.
57. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, lidhur me përdorimin e kredive të marra prej saj dhe personit të lidhur me të, z. F. Sh. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) pranë Fondacionit “B.” në vitet 2000 dhe 2001, në vlerën totale prej 1.800.000 lekësh, si burim për financimin e punimeve të ndërtimit të pasurisë objekt kontrolli. Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjeti të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mosvlerësimin si burim të ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt kontrolli të vlerës prej 1.800.000 lekësh të përfutur nga kreditë e marra pranë Fondacionit B. në vitet 2000 dhe 2001, duke mos i marrë në konsideratë këto vlera monetare si të hyra në analizën financiare të viteve respektive.
58. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të Komisionit lidhur me moskonsiderimin si burim të ligjshëm të përdorimit në vitin 2006 të një pjese të kredisë së marrë pranë Bankës Tirana në vitin 2005, në vlerën e 2.000.0000 lekëve, me argumentin se subjekti nuk e ka deklaruar gjendjen *cash* të mbetur pas tërheqjes së kredisë në gusht të të njëjtit vit, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
- 58.1. Në datën 17 maj 2005, mes Bankës Tirana, në cilësinë e huadhënësit, dhe subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe bashkëshortit të saj, në cilësinë e bashkëhuamarrësve, është lidhur para noterit publik kontrata për “Hua afatmesme” me nr. {***} rep., nr. {***} kol., për vlerën prej 2.000.000 lekësh. Qëllimi i huas, i deklaruar në kontratë, referuar pikës 2 të saj, është “Rikonstruksion banese”. Në DIPPV-në e të njëjtit vit (2005), në rubrikën e “Detyrimeve financiare”, subjekti ka deklaruar: *Kredi e marrë në Bankën Tirana (Dega Kavajë), marrë për ndërtimin e shtëpisë, katin e tretë, i deklaruar më parë dhe furgonin, në vlerë 2.000.000 lekë.* Në po të njëjtën deklaratë periodike, në rubrikën e “Deklarimit të interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar blerjen e një furgoni në vlerën e 250.000 lekëve, më datë 19.12.2005, me burim lekët e kredisë. Nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar likuiditete gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, ndonëse referuar llogarisë së kredisë, gjendja e likuiditeteve në datën 31.12.2005, rezultonte në vlerën e 36.515 lekëve.
- 58.2. Në DIPPV-në e vitit 2006, në rubrikën e “Deklarimit të interesave privatë, pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar: *Për katin e tretë të banesës së re të peregjistruar në ZRPP (Aplikuar për legalizim banese) – në rubrikën e vlerës së shtuar të pasurisë, subjekti ka deklaruar 1.250.000 lekë.* Ndërsa në rubrikën e “Detyrimeve financiare” të së njëjtës deklaratë periodike, subjekti ka deklaruar: *F. Sh., të ardhurat nga kredia e marrë janë përdorur për blerjen e një autoveture të deklaruar në vitin 2006 (furgon) në vlerën 250.000 lekë; ambientet*

e brendshme të kopshtit për fëmijë në vlerën 300.000 lekë; rikonstruksion i banesës dykatëshe (shtëpia ekzistuese) në vlerë 200.000 lekë; për katin e tretë të banesës së re të paregjistruar në ZVRPP (aplikuar për legalizim banese) në vlerë 1.250.000 lekë.

59. Në përgjigjet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit më datë 28.10.2019, lidhur me pyetjen e Komisionit mbi specifikimin e pagesave për ndërtimin dhe përdorimin e kredisë, subjekti i rivlerësimit është shprehur: *Me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.05.2005, nga Banka Tirana na janë dhënë hua 2.000.000 lekë. Në vitin 2005, nga shuma e disbursuar janë likuiduar një pjesë e kësteve mujore, meqenëse kishim fonde gjendje në bankë si rezultat i shtyrjes së investimit të planifikuar dhe diferenca është tërhequr nga bashkëshorti, z.F. Sh.. Në deklaratën vjetore të vitit 2005, kam deklaruar blerjen e një automjeti Ford, tipi “{***}”, lloji autoveturë (8+1), sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.12.2005, blerë në vlerën 250.000 lekë. Diferenca ka qenë në gjendje “cash” në shtëpi deri në fund të vitit 2005, bashkë me shumën e të hollave të vendosura nga ana jonë si rezultat i mosderdhjes së kësteve mujore në bankë, të cilat merreshin automatikisht nga gjendja disponibël në llogarinë rrjedhëse. Në deklaratën vjetore të vitit 2006, kam deklaruar se të ardhurat nga kredia e marrë janë përdorur për blerjen e një autoveture të deklaruar në vitin 2005 (data e dorëzimit 31.03.2006), furgon, në vlerën 250.000 lekë. Ambientet e brendshme të kopshtit për fëmijë në vlerën 300.000 lekë. Rikonstruksion i banesës 2-katëshe (shtëpia ekzistuese) në vlerën 200.000 lekë. Për katin e tretë të banesës së re, 1.250.000 lekë.*
60. Në shqyrtim të fakteve dhe rrethanave të konstatuara si më sipër, trupi gjykues, duke vlerësuar mbi bazën e një analize të ardhurash dhe shpenzimesh referuar fakteve të provuara gjatë hetimit administrativ në Komision, konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësinë e disponimit të një likuiditeti në gjendje *cash* në fund të vitit 2005, në vlerën e 1.628.822 lekëve, ndonëse kjo shumë apo pjesë e saj nuk rezultoi e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2005, si shtim i likuiditetit në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit si më sipër, se në vitin pasardhës ka përdorur pjesën e mbetur nga kredia e marrë në vitin 2005, në vlerën e 1.750.000 lekëve, për të kryer punimet e ndërtimit të katit të tretë të banesës, rikonstruksionin e banesës ekzistuese dhe investimin për ambientet e brendshme të kopshtit, konfirmon faktin se deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 pranë ILDKPKI-së, nuk ka qenë i saktë, në përputhje me ligjin.
61. Trupi gjykues gjen me vend të rikonfirmojë standardin tashmë të vendosur nga Kolegji, se likuiditetet e deklaruara fillimisht në bankë, nëse tërhiqen gjatë vitit të deklarimit dhe nuk deklarohen si gjendje likuiditeti *cash* jashtë sistemit bankar, prezumohen të shpenzuara, nëse nuk arrihet të provohet e kundërta nga subjektet e rivlerësimit. Në këtë kontekst, trupi gjykues, në kuadër të arritjes së një vendimi të drejtë dhe objektiv lidhur me kontrollin e krijimit të pasurisë “godinë e kombinuar 3-katëshe”, pasi mori në analizë faktet dhe rrethanat lidhur me kredinë e marrë në vitin 2005, pranë Bankës Tirana, në vlerën e 2.000.000 lekëve, duke mbajtur në konsideratë:
- (i) deklarimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2006 lidhur me mënyrën e përdorimit të kredisë e cila përputhet me destinimin e kredisë në deklaratën periodike të vitit 2005, teksa është deklaruar qëllimi i marrjes së saj *për ndërtimin e shtëpisë, katin e tretë, i deklaruar më parë dhe blerjen e furgonit;*
- (ii) vitin në të cilin është marrë kredia, i cili përkon me deklarimin e dytë periodik në raport me hyrjen në fuqi të këtij detyrimi ligjor, për të cilin edhe pasaktësia e konstatuar nga trupi gjykues për mosdeklarimin e gjendjes *cash* në banesë si pasojë e tërheqjes së vlerës së kredisë nga llogaria

përkatëse bankare, çmohet të ketë efekt të kufizuar vetëm në vlerësimin e saktësisë së deklaramit të vitit konkret, për sa kohë kjo pasaktësi në deklaram rezultatit e korrigjuar në deklaramin pasardhës; dhe

(iii) mbi të gjitha, faktin që pretendimi për ekzistencën e një likuiditeti gjendje *cash* në banesë në fund të vitit 2005, mbështetet edhe nga rezultati i analizës financiare të kryer nga Komisioni, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit mund të justifikonte me të ardhura të ligjshme kursimin në gjendje *cash* në banesë në vitin 2005, në vlerën e deklaruar si të përdorur në vitin 2006

– çmoi se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, në drejtim të mënyrës dhe kohës së përdorimit të fondeve të marra kredi nga Banka Tirana në vitin 2005, arritën të bindin trupin gjykues për besueshmërinë e tyre. Për rrjedhojë, trupi gjykues arriti në konkluzionin se mosdeklarimi në DIPPV-në e vitin 2005, i gjendjes së likuiditetit të pretenduar si *cash* në banesë dhe i deklaruar si i përdorur për burim krijimi pasurie në vitin 2006, është thjesht një pasaktësi në deklaramin periodik të vitit 2005 pranë ILDKPKI-së, e cila, referuar rrethanave të konstatuara më sipër, krijoi bindjen te trupi gjykues se likuiditeti ka qenë gjendje për t'u përdorur në vitin 2006, sipas destinacionit të treguar nga subjekti i rivlerësimit në DIPPV-në e vitit 2005 dhe rikonfirmuar në deklaramin e kryer në DIPPV-në e vitit 2006. Në këto kushte, trupi gjykues vlerësoi se konkluzioni i Komisionit për moskonsiderimin si burim të ligjshëm për kryerjen e punimeve të ndërtimit të pasurisë objekt kontrolli në vitin 2006, të një pjese të kredisë së marrë pranë Bankës Tirana, në vlerën e 1.250.000 lekëve, është i pabazuar në fakte.

62. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për vlerësim të gabuar të të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti i saj si i punësuar pranë shoqërisë “{***}” ShPK për vitin 2008, trupi gjykues, pasi analizoi shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerësimin në tërësi të të ardhurave të deklaruara, si të realizuara nga bashkëshorti i saj, z. F. Sh., si i punësuar pranë shoqërive “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe “{***}” për periudhën 2008-2016²², arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit për mosvlerësimin e këtyre të ardhurave si të ardhura të ligjshme në analizën financiare të vitit 2008, është i pabazuar në fakte dhe në ligj.
63. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues, pasi kreu verifikimet e nevojshme nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor në drejtim të pasqyrit të efekteve të konkluzioneve të arritura lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit për (i) kreditë e marra pranë Fondacionit B.; (ii) për një pjesë të kredisë së marrë pranë Bankës Tirana; si dhe (iii) për të ardhurat e deklaruara si të krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit si i punësuar pranë shoqërisë “{***}” ShPK në vitin 2008, arriti në përfundimin se shkakut i ankimit për konkluzion të gabuar të analizës financiare të Komisionit, lidhur me verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të pasurisë objekt kontrolli, është i bazuar në fakte dhe në ligj. Në përfundim të analizës së mësipërme, lidhur me shkaqet e ankimit të ngritura në drejtim të kontrollit të pasurisë “godinë e kombinuar me 3 kate”, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
64. Lidhur me pasurinën e luajtshme të llojit automjet, i tipit “Mitsubishi”, me vit prodhimi 2002, të blerë në vitin 2009, në vlerën e 5000 eurove, për të cilën subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni ka arritur në konkluzion të pabazuar për mospërputhje në deklarime, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.

²² Shih analizën në paragrafët 70 e në vijim në këtë vendim.

65. Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklarimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, si vijon: *Referuar pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllime të këtij ligji, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrime tatimore. Në përputhje me këtë dispozitë, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, janë përfshirë vetëm të ardhurat e dokumentuara për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.*
66. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, ka kundërshtuar si të pabazuar në fakte konkluzionin e Komisionit për mospërputhje të deklarimeve të subjektit lidhur me krijimin e kësaj pasurie me dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ. Subjekti pretendoi se kontrata e dhurimit e përpiluar në vitin 2012, për dhurimin nga z. I. Sh. të pjesës së tij, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, është një kontratë formale për shkak se në kontratën e shitblerjes së automjetit në vitin 2009, z. I. S. është përfshirë si bashkëblerës i automjetit (për arsye të përdorimit të automjetit edhe nga ky person për aktivitetin e tij privat në ndihmë të bashkëshortit të saj), pavarësisht se e gjithë vlera e automjetit është paguar në momentin e blerjes, në vitin 2009, nga z. F. Sh..
67. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstatoi fillimisht se konkluzioni i Komisionit është jo i qartë. Komisioni nuk ka mbajtur një qëndrim konkret lidhur me kontrollin e ushtruar për këtë pasuri të subjektit të rivlerësimit, nëse subjekti ka kryer deklarim të saktë dhe ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie, apo deklarimi i saj vlerësohet i pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe për cilin prej shkaqeve ligjore të përcaktuara nga neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Ndonëse nga leximi i pjesës 3.3, “Analiza financiare”, e paraqitur në faqet 20-21 të vendimit, kuptohet që sipas analizës financiare të kryer nga Komisioni, subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, në pjesën arsyetuese Komisioni është mjaftuar vetëm me citimin e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pa dalë në një konkluzion përmbledhës për pasurinë objekt kontrolli.
68. Në analizë të qëndrimit që ka mbajtur Komisioni në vendim lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues vlerësoi se shkaku i ngritur nga subjekti i rivlerësimit se konkluzioni i Komisionit për mospërputhje të deklarimeve të subjektit lidhur me krijimin e kësaj pasurie me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, është i pabazuar në fakte, nuk është relevant për zgjidhjen e çështjes dhe vlerësimin e pasurisë objekt kontrolli. Ndonëse Komisioni ka konstatuar fillimisht se nuk përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar në dosje, qëndrimin final lidhur me këtë pasuri e mban vetëm në drejtim të burimeve të ligjshme për krijimin e saj. Në këtë kontekst, mospërputhjet që pretendohet se ka konstatuar fillimisht Komisioni, nuk kanë pasur peshë në vlerësimin përfundimtar lidhur me këtë pasuri, e cila lihet të kuptohet se është pamjaftueshmëria në burime të ligjshme për blerjen e saj në masën e 468.122 lekëve.
69. Sa i takon çështjes së pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit në vitin 2009, subjekti duket se këtë konkluzion të Komisionit e ka prapësuar nëpërmjet kundërshtimit të analizës financiare të vitit 2008, në drejtim të mosmarrjes në konsideratë të të ardhurave të bashkëshortit nga punësimi pranë shoqërisë “{***}” ShPK, duke qenë se si burim për blerjen e automjetit të tipit “Mitsubishi” në vitin 2009, ka deklaruar: *lekë të ruajtura në vitin 2008, në vlerën 600.000 lekë dhe pjesa tjetër e fituar gjatë muajve janar dhe shkurt 2009.* Në këtë kuptim, në vijim të konkluzionit të arritur lidhur me të ardhurat e krijuara nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit pranë shoqërisë “{***}” ShPK, trupi gjykues, pasi pasqyroi nëpërmjet Njesisë së

Shërbimit Ligjor, në analizën financiare të vitit 2008, efektin e shtimit si të hyra të të ardhurave të krijuara nga punësimi i z. F. Sh., si më sipër cituar, në vlerën e 396.675 lekëve, konstatoi se kursimi i deklaruar gjendje *cash* në banesë, në vlerën e 600.000 lekëve, nga subjekti i rivlerësimit, justifikohet me burime të ligjshme deri në masën e 528.553 lekëve. Për rrjedhojë, vetëm kjo vlerë kursimi mund të përdoret si burim i ligjshëm për blerjen e automjetit objekt kontrolli. Në përfundim, nga analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve të kryera deri në momentin e blerjes së automjetit më datë 18.02.2009, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të justifikojnë me të ardhura të ligjshme blerjen e automjetit të tipit “Mitsubishi”, me vit prodhimi 2002, në vlerën e 5000 eurove.

70. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për vitet 2008-2016 pranë shoqërive “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, për të cilat subjekti i rivlerësimit pretendoi se konkluzioni i Komisionit është i pabazuar në ligj, trupi gjykues konstatoi si më poshtë.
71. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga paga, si i punësuar pranë këtyre shoqërive, si vijon: *Komisioni, për të vlerësuar të ardhurat e ligjshme, analizoi informacionin zyrtar të ardhur nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe dokumentacionin e ardhur nga bankat, ku pasqyrohen kalime periodike të të ardhurave nga paga në llogaritë në emër të bashkëshortit të subjektit. Të ardhurat e përfituara me bankë, kanë rezultuar në shumën 5.460.035 lekë, ndërsa të ardhurat për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, kanë rezultuar në shumën prej 1.501.576 lekësh. Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave në tërësi, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklarim të pasaktë në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortit dhe pagat e përfituara nga punësimi pranë shoqërive “{***}”, “{***}” dhe “{***}”. Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin ligjor për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, referuar pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ku parashikohet se pasuritë e ligjshme për qëllime të këtij ligji, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrime tatimore.*
72. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, ka kundërshtuar si të gabuar dhe të pabazuar përlllogaritjen e Komisionit lidhur me të ardhurat nga paga të bashkëshortit të saj, për periudhën 2008-2016, si i punësuar pranë shoqërive “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK dhe, për rrjedhojë, edhe konkluzionin e Komisionit për deklarim të pasaktë të të ardhurave të bashkëshortit të saj. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, pretendoi se të ardhurat nga paga të deklaruar nga bashkëshorti i saj në deklarimet periodike, përputhen me vlerat e arkëtuara në bankë, në llogarinë e pagës, që u korrespondojnë pagesave që kanë bërë shoqëritë punëdhënëse. Subjekti i rivlerësimit, duke iu referuar parashikimeve ligjore të zbatueshme në drejtim të detyrimeve për pagesat e kontributeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimit mbi të ardhurat nga paga në një marrëdhënie punësimi, pretendoi se nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi bashkëshorti i saj për mospërbushjen e detyrimeve ligjore nga ana e punëdhënësit. Subjekti shprehet se për dëmtimin e interesave pasurorë të të shoqit, ky i fundit sapo ka marrë dijani për këtë fakt, ka paditur pranë gjykatës kompetente punëdhënësin. Subjekti argumentoi se, referuar parashikimeve të legjislacionit të zbatueshëm në fuqi, punëmarrësi nuk mund të mbajë përgjegjësi për veprimet e kryera nga pala punëdhënëse.
73. Nga shqyrtimi i këtij shkak ankimi, trupi gjykues, pasi verifikoi aktet e fashikullit të çështjes lidhur me të ardhurat e krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga paga, si i punësuar pranë shoqërive “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, në periudhën e viteve 2008-2016, konstatoi si vijon.

73.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, ka deklaruar se bashkëshorti i saj, nga marrëdhëniet e punësimit pranë: (i) shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, për periudhën e viteve 2008-2015, ka krijuar të ardhura neto në vlerën e 5.122.270 lekëve; dhe (ii) shoqërisë “{***}” ShPK, për vitin 2015 dhe vitin 2016, ka realizuar të ardhura neto në vlerën e 595.000 lekëve – të cilat në total arrijnë vlerën e 5.717.270 lekëve. Këtë deklaram, subjekti i rivlerësimit e ka shoqëruar, në cilësinë e dokumentacionit justifikues, sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me lëvizjet e llogarive bankare në të cilat janë derdhur pagat mujore nga shoqëritë punëdhënëse sipas periudhave përkatëse.

73.2. Subjekti ka paraqitur në kuadër të dokumentacionit justifikues, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, edhe disa vërtetime nga shoqëritë punëdhënëse²³, sipas të cilave vërtetohet punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. F. Sh., pranë këtyre shoqërive, si dhe pagat e përfituara në vlera neto. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë edhe një shkresë të Institutit të Sigurimeve Shoqërore²⁴, në të cilën, në përgjigje të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, shkruhet: *Nga verifikimi i kryer në Drejtorinë e Arkivit Qendror, rezulton se z. F. Sh. figuron në subjektin “{***}” ShPK, me dosje nr. {***}, për periudhën janar 2009 - dhjetor 2012. Gjithashtu, ky arkiv nuk disponon dokumentacion të vjetërsisë në punë si bordero, apo libra page për subjektin “{***}” ShPK. Në vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, bashkëlidhur shkresës së mësipërme, konstatohet se z. F. Sh., për periudhën janar 2009 - dhjetor 2012, ka realizuar të ardhura bazë dhe për të është derdhur kontribut nga subjekti “{***}” ShPK, dosja {***}, me pagë bazë bruto, në vlerën prej 35.200 lekëve, ndërkohë që rezultoi se, sipas vërtetimeve të punëdhënësit, shoqëria “{***}” ShPK, z. F. Sh. paguhej me pagë neto mujore në vlerën 70 mijë lekë dhe se marrëdhënia e punësimit të tij kishte filluar që në muajin maj të vitit 2008.*

73.3. Gjatë hetimit të kryer nga ILDKPKI-ja në drejtim të të ardhurave bruto dhe neto të realizuara sipas secilit vit të punës, të deklaruara nga punëdhënësit (jo shtetëror) pranë organeve kompetente, është administruar shkresa nr. {***} prot., datë 28.07.2017, e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, me anë të së cilës informohet ILDKPKI-ja lidhur me punësimin e z. F. Sh. pranë subjekteve “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe “{***}”, sipas ekstraktit historik të punonjësit bashkëlidhur shkresës, nga ku evidentohet se pagat bruto të deklaruara nga shoqëritë punëdhënëse në cilësinë e tatimpaguesve janë dukshëm më të vogla se pagat e deklaruara prej tyre në vërtetimet e lëshuara ndër vite si më sipër cituar, si dhe më të vogla se pagesat e derdhura rregullisht në llogaritë përkatëse bankare të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, në

²³ - Vërtetimet nr. {***} prot., datë 07.04.2011 dhe nr. {***}, datë 18.03.2012 të shoqërisë “{***}” SHPK të nënshkruar nga administratori, në të cilën vërtetohet se z. F. Sh., është punonjës i kësaj shoqërie nga data 09.05.2008 me pagë mujore neto është 70.000 lekë.

- Vërtetimet nr. {***} prot, datë 27.03.2014 dhe nr. {***} prot, datë 10.03.2015 të shoqërisë “{***}” SHPK, të nënshkruar nga administratori me të cilën vërtetohet se z. F. Sh. është punonjës i kësaj shoqërie nga data 02.09.2013 dhe në vazhdim me pagë mujore 65.000 lekë.

- Vërtetim nr. {***} prot, datë 18.03.2016, të shoqërisë “{***}” SHPK të nënshkruar nga administratori në të cilën vërtetohet se z. F. Sh., është i punësuar pranë kësaj shoqërie me pagë 30.000 (tridhjetë mijë) lekë.

- Vërtetim nr. {***} prot, datë 23.12.2016 të së njëjtës shoqëri (“{***}” SHPK) në të cilën vërtetohet se z. F. Sh., është i punësuar pranë kësaj shoqërie nga periudha 17.09.2015 – vazhdim, me një pagë mujore (neto+ orë shtesë) 45.000 lekë.

²⁴ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 14.11.2016 të Degës së Arkivës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

të cilat derdhej paga. I njëjti informacion konfirmohet edhe nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me shkresën e tij drejtuar ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 30.06.2017.

73.4. Gjatë fazës së hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë edhe tri kërkesëpadi, me anë të së cilave ka paditur shoqëritë punëdhënëse, duke kërkuar gjyqësisht detyrimin e punëdhënësve për të paguar kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe detyrimet tatimore mbi të ardhurat personale për periudhat respektive të punësimit pranë tyre²⁵, si dhe dy vërtetime nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe një vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, secili me datë 05.03.2020, me anë të së cilave provohet se pranë këtyre gjykatave janë regjistruar dhe janë në gjykim e sipër çështjet civile që u përkasin palëve të përmendura në paditë e referuara më sipër. Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, së bashku me parashtrimet e saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, ka dorëzuar edhe vendimin e formës së prerë nr. 230, datë 29.09.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për pranimin e pjesëshëm të kërkesëpadisë së ngritur ndaj Shoqërisë “{***}” ShPK²⁶ dhe një vërtetim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 13.07.2022, në të cilin paraqitet dispozitivi i vendimit nr. 7791, datë 02.12.2021, i së njëjtës gjykatë²⁷.

- 74.** Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues, në konsideratë të faktit se marrëdhënia e punësimit pranë shoqërive tregtare “{***}” ShPK, “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK konfirmohet nga vetë organi tatimor²⁸, si dhe se pagesat (pagat) mujore kanë kaluar nëpërmjet sistemit bankar dhe vlerat e derdhura në bankë përputhen me vlerat e deklaruara në vërtetimet e punëdhënësve, si dhe me vlerat e deklaruara nga subjekti në deklaratimet periodike dhe atë të pasurisë *vetting*, trupi gjykues vlerëson se vërtetimet e shoqërive punëdhënëse të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, kanë vlerën e provës në lidhje me masën e pagës së dakordësuar mes punëdhënësve dhe

²⁵ Kërkesëpaditë e përcjella nga subjekti i rivlerësimit në Komision, janë:

(i) kërkesëpadi drejtuar për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditës F. Sh., të paditur Shoqëria “{***}” ShPK, person të interesuar Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, dhe me objekt “Detyrimin e palës së paditur të paguajë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën gusht 2013 - qershor 2015. Detyrimin e palës së paditur të paguajë detyrimet tatimore mbi të ardhurat personale, për periudhën gusht 2013 - qershor 2015;

(ii) kërkesëpadi drejtuar për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me paditës F. Sh., të paditur Shoqëria “{***}” ShPK, person të interesuar Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë, dhe me objekt “Detyrimin e palës së paditur të paguajë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën shtator 2015 - nëntor 2017. Detyrimin e palës së paditur të paguajë detyrimet tatimore mbi të ardhurat personale, për periudhën shtator 2015 - nëntor 2017;

(iii) kërkesëpadi drejtuar për kompetencë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, me paditës F. Sh., të paditur Shoqëria “{***}” ShPK, person të interesuar Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Durrës, dhe me objekt “Detyrimin e palës së paditur të paguajë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën maj 2008 - gusht 2013. Detyrimin e palës së paditur të paguajë detyrimet tatimore mbi të ardhurat personale për periudhën nga maj 2008 – gusht 2013.

²⁶ Sipas këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Krujës ka vendosur detyrimin e shoqërisë “{***}” ShPK për të paguar kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe detyrimet tatimore mbi të ardhurat personale për periudhat maj 2008 - gusht 2009, tetor 2009 - dhjetor 2010, shkurt 2011 - shkurt 2013 dhe prill 2013.

²⁷ Referuar dispozitivit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. {***}, datë 02.12.2021, gjykata ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë duke vendosur edhe detyrimin e shoqërisë “{***}” ShPK për të paguar kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe detyrimet tatimore mbi të ardhurat personale.

²⁸ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 28.07.2017, të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, trajtuar në parag. 75.3 në këtë vendim.

punëmarrësit, përfitimi apo jo i së cilës në lidhje me verifikimin e të ardhurave totale vjetore të përfituara, do të kryhet sipas depozitimeve në llogarinë përkatëse të pagës së z. F. Sh.. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon se konkluzioni i Komisionit për deklarim të pasaktë të të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, është i pabazuar në fakte.

75. Ndërsa sa i takon vlerësimit të ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, në kuadër të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht se nga hetimi rezultoi që për një pjesë të të ardhurave të krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk janë përmbushur detyrimet tatimore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, fakti që ky detyrim, referuar parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar²⁹ dhe të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar³⁰, bie mbi palën punëdhënëse, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mund të penalizohen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në drejtim të vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave të realizuara nga punësimi, për sa kohë nuk provohet që mospërmbushja e detyrimeve të palës punëdhënëse ka qenë e ditur dhe, rrjedhimisht, e pranuar nga punëmarrësi.
76. Në kuadër të vlerësimit të qenies apo jo në mirëbesim të punëmarrësit lidhur me pagesat e detyrimeve që lindin nga paga, trupi gjykues mbajti në konsideratë faktin që pagesat janë kryer në tërësinë e tyre, në masën e pretenduar, nëpërmjet sistemit bankar, sikundër edhe se vërtetimet e vazhdueshme të marra nga z. F. Sh. nga punëdhënësit e tij, për efekt dokumentacioni, konfirmonin pagën e pretenduar prej tij, çka vlerësohet nga trupi gjykues se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk ka qenë në kushtet për të vënë në dyshim se lidhur me pagesat e përfituara nga punësimi i tij, nuk ishin shlyer nga punëdhënësit detyrimet me natyrë tatimore ndaj shtetit. Gjithashtu, në kuadër të kësaj analize, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe kërkesëpaditë e ngritura ndaj shoqërive punëmarrëse, me objekt përmbushjen e detyrimeve tatimore ndaj organeve shtetërore kompetente³¹, duke konfirmuar në këtë drejtim bindjen se punëmarrësi, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, nuk ka qenë në keqbesim në raport me sjelljen e palës punëdhënëse.

²⁹ Në nenin 10, “Mbledhja e tatimit”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, përcaktohet:

“1. Çdo punëdhënës, që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në germën “a” të nenit 8 të këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 9 të këtij ligji dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore, jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës.

2. Të gjithë punëdhënësit mbajnë regjistrime të pagesave të specifikuara në germën “a” të nenit 8 të këtij ligji, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

3. Të gjithë punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar janë të detyruar të deklarojnë tatimin mbi të ardhurat vetjake, të mbajtur në burim për punëmarrësit. Forma, përmbajtja, afatet dhe procedurat e dorëzimit të deklaratave përcaktohen në udhëzimin e ministrit të Financave të nxjerrë në zbatim të këtij ligji”.

³⁰ Në nenin 6 të ligjit 9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet:

“1. Personi i detyruar për të paguar kontributet është përgjegjës për llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e kontributeve në kohën dhe në masën e duhur.

2. Punëdhënësi është përgjegjës për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit dhe për pagesën në organet tatimore, së bashku me kontributet e punëdhënësit [...]”.

³¹ Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në kërkesëpadi se ka marrë dijeni të faktit të mospërmbushjes së detyrimeve nga ana e subjekteve punëdhënëse nga shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. {***}, datë 28.07.2017, me

77. Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit – për mosvlerësimin si të ardhura të ligjshme të vlerës totale të pagave të përfituara nga punësimi në këto shoqëri tregtare dhe të paguara prej tyre nëpërmjet sistemit bankar, me justifikimin se për këto pagesa nuk janë përmbushur detyrimet tatimore nga ana e punëdhënësve – është i pabazuar në ligj. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk gjenden në kushtet e deklarimit të pasaktë të të ardhurave të përfituara nga bashkëshorti, z. F. Sh., si më sipër shpjeguar, dhe se këto të ardhura nuk cenojnë standardin e të ardhurave të ligjshme, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Si të tilla, këto të ardhura nga paga duhet të ishin marrë në konsideratë nga ana e Komisionit në analizën financiare të kryer, në kuadër të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme, për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera, në periudhën e viteve 2008 – 2016.
78. Në vijim të konkluzionit të arritur lidhur me pagat e realizuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për vitin 2012, nga punësimi i tij pranë shoqërisë “{***}” ShPK, trupi gjykues, pasi kontrolloi nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor analizën financiare të kryer nga Komisioni për këtë vit, arriti në konkluzionin se përfshirja në zërin e të hyrave të pagave të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në vlerën e 880.000 lekëve, sjell si pasojë një bilanc pozitiv në vlerën e +383.305 lekëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se shkaku i ankimit të subjektit të rivlerësimit për konkluzion të gabuar të Komisionit në lidhje me rezultatin e analizës financiare të këtij viti, është i drejtë dhe i bazuar në fakte.
79. Për rrjedhojë, nga vlerësimi dhe kontrolli i imtësishëm i kryer në Kolegj lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, në kuadër të kontrollit të vendimit të Komisionit objekt ankimi, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së saj. Për pasojë, konkluzioni i Komisionit lidhur me këtë kriter vlerësimi, konsiderohet i pabazuar në faktet e provuara dhe në ligj dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret si bazë për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra.
80. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, bazuar në analizën e mësipërme faktike dhe ligjore, çmon se subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Pavarësisht konkluzionit të mësipërm, bazuar në parashikimin e nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, nuk mund të konfirmohet në detyrë nga Kolegji, për arsye se Komisioni në vendimin e tij nuk ka konkluduar lidhur me vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale. Në këto kushte, vendimi i Komisionit objekt ankimi duhet të priset dhe Komisioni, në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, duhet të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

të cilën është njohur pas datës 20.11.2019 (duke iu referuar këtu datës në të cilën ka marrë kopje të akteve të fashikullit të Komisionit).

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Të prishë vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 254, datë 04.06.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula.
2. Të urdhërojë Komisionin e Pavarur të Kualifikimit të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Entela Shedula, edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 22.09.2022, në Tiranë.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi – kundër

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, anëtare e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), që shqyrtoi ankimin e Komisionerit Publik (në vijim “KP”) ndaj vendimit nr. 254, datë 04.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dakordësohem me vendimin e trupit gjykues sa i përket zgjidhjes së çështjes, por po parashtroj një arsyetim paralel, të ndryshëm nga arsyetimi i shumicës, në këtë vendim.
2. Arsyetimi i ndryshëm lidhet me konkluzionin e trupit gjykues sa i përket konsiderimit të kredisë së marrë nga subjekti në Fondin B., si burim për shpenzimet e ndërtimit të *pasurisë së paluajtshme, të llojit “godinë e kombinuar 3-katëshe”, me sip. 174,9 m² secili kat, me vendndodhje Kavajë*, në një vlerësim të ndryshëm të situatës faktike, bazuar në deklaratimet periodike të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të tjerë të lidhur, si dhe në ligjin e zbatueshëm lidhur me të.

Komisioni, në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka arsyetuar në vendimin e tij lidhur me kontrollin e kryer mbi saktësinë e deklaratimit dhe verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, ndër të tjera, si vijon: ***i. Në lidhje me burimet e ligjshme për krijimin e pasurisë [...]*** ***iii. Në lidhje me kreditë e Fondit B., të deklaruara si një nga burimet e krijimit të pasurisë*** – *Komisioni nuk u bind me shpjegimet e dhëna nga subjekti në lidhje me përdorimin e kredive për ndërtimin e shtëpisë, pasi qëllimi i marrjes së tyre ishte për biznes. Kontratat e kredive, nënshkruar nga subjekti dhe bashkëshorti, janë akte ligjore referuar nenit 690 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të cilat kanë fuqinë e ligjit për palët. Në objektin e kontratave dhe në aktet bashkëlidhur, përcaktohet qartësisht qëllimi i marrjes së këtyre kredive për aktivitet tregtar.*

3. Shumica në vendim, në vlerësim të shkakut të ankimit të paraqitur lidhur me verifikimin e burimeve të ligjshme për ndërtimin e godinës objekt kontrolli, ka pranuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të konsiderimit të kredive të marra nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe bashkëshorti i saj pranë Fondacionit B., si burime të ligjshme për krijimin e *pasurisë së paluajtshme të llojit “godinë e kombinuar 3-katëshe”, në Kavajë*. Në vlerësimin tim, për këtë shkak ankimi, shumica nuk ka bërë një vlerësim harmonik dhe logjik të provave të administruara në fashikullin gjyqësor të çështjes, veçanërisht të deklaratave periodike të subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe të personave të tjerë të lidhur me të. Bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), deklaratat e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë në ILDKPKI, në kuadër të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”) mund të përdoren si provë në procesin e rivlerësimit. Nëpërmjet deklaratave periodike të pasurisë, kontrollohet saktësia e deklaratimeve të bëra nga subjektet e rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, pra ato mund të shërbejnë për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë në lidhje me pasuritë e deklaruara dhe burimet e krijimit të tyre.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe personi i lidhur [bashkëshorti i saj] kanë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, për herë të parë vetëm 2 nga 4 kreditë³² e përfituara në vitet 2000 dhe 2001 nga Fondacionit B., si burim për krijimin e pasurisë *godinë e kombinuar 3-katëshe*, në Kavajë. Për të kontrolluar saktësinë e këtij deklarimi, shumica duhet të kishte vlerësuar nëse subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe bashkëshorti i saj, në zbatim të përcaktimeve të nenit 6 të ligjit nr. 9049/2003, në deklaratat vjetore për këtë pasuri, kishin deklaruar si burim krijimi kreditë e përfituara nga Fondacioni B..

3.1 Nga verifikimi i deklaratave periodike të pasurisë, rezulton si vijon:

a) Në deklaratën për herë të parë të pasurisë në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur [bashkëshorti i saj] nuk e kanë deklaruar këtë pasuri, duke mos respektuar përcaktimin e nenit 4, shkronja “a” dhe të nenit 6 të ligjit nr. 9049/2003, lidhur me detyrimin për të deklaruar pasuritë e paluajtshme të akumuluar deri në këtë vit dhe të drejtat reale mbi to, si dhe burimet e origjinën e tyre.

Në këtë deklaratë, për këtë pasuri, në mënyrë të pakuptimtë, rezultojnë dy deklarime të personit tjetër të lidhur të subjektit të rivlerësimit [vjehtë të saj], në përmbajtje të ndryshme me njëra-tjetrën. Gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, por dhe gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, nuk ka shpjeguar bindshëm arsyet:

- a) përse nuk e kishte deklaruar këtë pasuri; si dhe
- b) që vjehtëri i saj kishte deklaruar në të njëjtin vit këtë pasuri, si në formularin A-1 të deklarimit të vitit 2003, por edhe në një deklaratë me shkrim dore që i ka bashkëngjitur po këtij deklarimi, në përmbajtjen e së cilës nuk specifikohet asnjë e dhënë shtesë lidhur me këtë pasuri, përkundrazi në të pasqyrohen më pak të dhëna se ato të deklaruara në formularin A-1 [sa u përket pjesëve takuese dhe burimeve të krijimit, përfshirë dhe kreditë e marra nga Fondacioni “B.”]. Për më tepër, një pjesë e burimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe bashkëshorti i saj në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk janë deklaruar as nga personi tjetër i lidhur, vjehtëri i saj.

Në vlerësimin tim, mosdeklarimi i kësaj pasurie në vitin 2003 nga vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe bashkëshorti i saj, ka qenë një zgjedhje e saj dhe jo një paqartësi nëse duhet të deklaronte pasurinë, pjesën takuese prej 1/3 mbi këtë pasuri, si dhe burimet e krijimit të saj. Këtë vlerësim e mbështes në faktin që në të njëjtën deklaratë, pra atë të vitit 2003³³, vjehtëri i saj, përveçse kishte deklaruar këtë pasuri, kishte dhënë dhe pjesën e tij takuese në të, çka nënkuptonte se deklarimi për pjesët e tjera takuese, burimet e krijimit, si dhe elementet e tjera të kërkuara nga

³² Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, ka pretenduar që burim krijimi për këtë pasuri, kanë qenë 4 kredi, ndërkohë që në deklaratën “vetting”, ajo dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar si burim vetëm 2 prej tyre. Vetëm pasi u pyet në seancën gjyqësore në Kolegj se përse kishte deklaruar në deklaratën e pasurisë “vetting” vetëm 2 prej tyre, subjekti dha shpjegime se ishte thjesht pasaktësi, deklarimi i vetëm 2 prej tyre, në mënyrë të njëjtë si prej saj, edhe prej bashkëshortit.

³³ E dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit si subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003.

ligji, duheshin deklaruar në formularët përkatës nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe bashkëshorti i saj³⁴.

b) Në deklaratën vjetore të pasurisë për vitin 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri, me përshkrimin “banesë, kati përdhe magazinë, kati i parë i banuar i përfunduar, kati i dytë i papërfunduar”, ka deklaruar pjesën takuese 1/3-a, nuk ka deklaruar vlerën e pasurisë, duke vendosur shënimin: “vlera pas përfundimit në total të banesës”, si dhe nuk ka deklaruar burimin e krijimit të saj, deklarime dhe veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e nenit 6 të ligjit nr. 9049/2013 (i ndryshuar).

3.2 Në një vlerësim harmonik dhe logjik të këtyre provave, pra deklarimit të personit tjetër të lidhur [vjehtërit të subjektit] në deklaratën e vitit 2003 dhe deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2004, mosdeklarimi në vitin 2004 nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, i vlerës së ndërtimit dhe i burimeve të krijimit të kësaj pasurie, ndërkohë që ato ishin deklaruar dhe identifikuar prej vjehtërit të saj vetëm një vit më parë³⁵, nuk është një harresë e subjektit, por një shmangie e saj nga zbatimi i detyrimeve të nenit 6 të ligjit nr. 9049/2003. Subjekti i rivlerësimit, në zbatim të këtij detyrimi ligjor, duhet të kishte bërë një deklarim të saktë dhe të plotë të pasurive në posedim/përdorim prej vitit 2003, dhe logjikisht në vitin 2004³⁶, duke qenë se pasuria nuk kishte pasur asnjë zhvillim dhe nuk ishte kryer asnjë shpenzim lidhur me të³⁷, duhet të kishte deklaruar të njëjtën vlerë pasurie, si edhe burimet e krijimit të saj, ashtu si i kishte deklaruar vjehtëri i saj në deklarimin e vitit 2003³⁸. Mbështetur në rrethanat dhe argumentet e mësipërme, vlerësoj se mosdeklarimi nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, i vlerës së pasurisë deri në vitin 2004, si dhe i burimeve të krijimit të saj, bën të pabesueshme për vërtetësinë e tyre edhe deklarimet e vjehtërit të saj në vitin 2003, përfshirë deklarimet e këtij të fundit për burimin e krijimit të pasurisë [ndër të tjera, edhe për kreditë e përfituara nga Fondacioni B.].

3.3 Bazuar në sa më sipër, deklarimet kontradiktore dhe zgjedhja e subjektit për mosdeklarim të kësaj pasurie, me të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 6 të ligjit nr. 9049/2003, në vlerësimin tim, bëjnë të pabesueshëm deklarimin e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe nuk krijojnë bindjen se kreditë e marra në Fondacionin B. kanë shërbyer si burime për krijimin e kësaj pasurie. Mosarritja e besueshmërisë në deklarimet e subjektit për këtë pasuri, mban në konsideratë edhe faktin që edhe sa u përket fazave të ndërtimit të pasurisë dhe shpenzimeve konkrete të kryera për secilën prej tyre para vitit 2005³⁹, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula,

³⁴ Sjell në vëmendje që personi tjetër i lidhur, vjehtëri i saj i moshuar, ishte treguar tepër i kujdesshëm për të deklaruar se në këtë objekt 3-katësh, pjesa takuese e tij ishte 1/3, ndërsa subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe bashkëshorti i saj nuk e kanë bërë këtë gjë.

³⁵ Në deklaratën për herë të parë në vitin 2003.

³⁶ Viti 2004 është viti kur subjekti ka deklaruar për herë të parë personalisht këtë pasuri.

³⁷ Gjithmonë sipas deklarimeve dhe shpjegimeve të subjektit.

³⁸ Personi tjetër i lidhur, vjehtëri i saj, në vitin 2003 kishte përlllogaritur vlerën e pasurisë, prej 6,2 milionë lekësh, madje kishte identifikuar si burim krijimi pasurie, kreditë e marra në Fondacionin B. nga vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe bashkëshorti i saj.

³⁹ Sipas deklaratave periodike, por dhe deklarimeve të subjektit gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, pasuria, ndërtesë 2-katëshe [në atë kohë], nuk ka pasur zhvillim dhe shpenzim për ndërtim gjatë vitit 2004.

ka zgjedhur të bëjë deklaratime të paplota në deklaratat e pasurisë së viteve 2003 dhe 2004⁴⁰, madje ka qenë tërësisht deklarative lidhur me to edhe gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, pa mbështetur deklaratimet dhe shpjegimet e saj në dokumentacion justifikues ligjor. Për këtë arsye, procesi i kontrollit për mundësinë e mbulimit me burime të ligjshme financiare të ndërtimit të kësaj pasurie, në Komision, por edhe në Kolegj, është bazuar tërësisht vetëm në shpjegime dhe deklaratime të bëra prej saj gjatë procesit, si dhe në përlllogaritje hipotetike të sasisë/nivelit së/të punimeve të kryera për këtë pasuri para dhe pas martesës së saj deri në vitin 2003. Kjo qasje e saj gjatë procesit, ka passjellë një vlerësim hipotetik për mungesën e burimeve financiare të ligjshme për shpenzimet financiare të kryera për fazat e ndërtimit të deklaruara, por jo të dokumentuara, para dhe pas martese, deri në vitin 2003, duke mos realizuar një analizë objektive, të bazuar në fakte dhe dokumentacion justifikues ligjor, e cila do të përcaktonte qartësisht, për rrjedhojë, edhe përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit për mungesën e burimeve të ligjshme sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

4. Gjithashtu, konsideroj jobindës dhe me peshë jopërcaktuese për të mbështetur versionin e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, argumentin e shumicës se mospasqyrimi si detyrim i kredive të marra në Fondacionin B., në bilancet e periudhës 2000-2003, konfirmon faktin se ato nuk janë përdorur për qëllimin e parashikuar në përmbajtje të kontratave të hipotekimit të kredisë, pra për aktivitetin ekonomik të bashkëshortit të saj për “Tregti konfeksione”.

4.1 Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie, “të ardhura të fituara nga aktiviteti privat, tregti me shumicë të artikujve të përzier, ushqimore, pije, duhan”. Vetëm në deklaratën e pasurisë *vetting*⁴¹, subjekti i rivlerësimit ka identifikuar se kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, fitimi neto i personit fizik në pronësi të bashkëshortit të saj për vitin 2000, në shumën rreth 515 mijë lekë; për vitin 2001, në shumën rreth 417 mijë lekë; për vitin 2002, në shumën rreth 589 mijë lekë; për vitin 2003, në shumën rreth 855 mijë lekë. Nga deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe aktet e administruara në fashikull, rezulton se kreditë e përfituara nga Fondacioni B. janë shlyer tërësisht në vitet 2002 dhe 2003.

4.2 Pasqyrimi i një detyrimi kredie/huaje në bilancet e shoqërisë, është një veprim i cili duhet të bëhet në përputhje me rregullat e kontabilitetit, por për mospasqyrimin e tij, personi i ngarkuar nga ligji për të kryer këtë veprim, mbart përgjegjësi administrative, ndërsa personi fizik, në këtë rast personi fizik “{***}”, mbart përgjegjësi sipas legjislacionit fiskal në fuqi. Për sa më sipër, vlerësoj se shumica ka gabuar kur ka deduktuar që meqenëse këto detyrime nuk janë pasqyruar në bilancet e viteve 2000-2003, këto detyrime nuk kanë ekzistuar për personin fizik “{***}”, për më tepër të konkludohet që kjo kredi apo hua nuk është përdorur për këtë aktivitet ekonomik. Në vlerësimin tim, pasqyrimi i kredive të Fondacionit B. në bilancet e personit fizik në pronësi të bashkëshortit,

⁴⁰ Mosdeklarim tërësisht të pasurisë në vitin 2003, mosdeklarim vlere të shpenzuar në deklarin e kësaj pasurie për herë të parë nga subjekti, në vitin 2004

⁴¹ Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, nuk ka deklaruar burimin në deklaratën vjetore të pasurisë në vitin 2004, por edhe personi tjetër i lidhur, vjehri i saj, në deklarimin për herë të parë, nuk ka identifikuar këto të ardhura nga fitimi neto si burim për krijimin e ndërtesës 3-katëshe.

bazuar në legjislacionin e kontabilitetit, por dhe atë fiskal në fuqi në atë kohë, do të rriste në mënyrë të drejtpërdrejtë shpenzimet e këtij personi fizik për pagimin e kësteve të kredive të përfituara nga Fondacioni B., duke ulur ose reduktuar tërësisht fitimin neto të tij nga ky aktivitet, në periudhën e viteve 2000-2003, për rrjedhojë do të ulte ose zeronte dhe një burim tjetër të deklaruar për këtë pasuri në deklaratën e pasurisë *vetting*, të ardhurat nga fitimi neto i aktivitetit ekonomik të bashkëshortit.

5. Bazuar në një interpretim harmonik dhe logjik të deklaratave periodike të pasurisë të cilat kanë cilësinë e provës në këtë proces, si dhe të fakteve të referuara si më sipër, kam vlerësuar si jobindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se kreditë e marra nga Fondacioni B. kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurisë, ndërtesë 3-katëshe, në Kavajë, duke e gjetur të drejtë me një arsyetim të ndryshëm konkluzionin e Komisionit se ato nuk kanë qenë burim krijimi për këtë pasuri. Për rrjedhojë, shuma prej 1.800.000 lekësh, e marrë hua/kredi pranë Fondacionit B., në vlerësimin tim, nuk duhej të përfshihej në analizën financiare të kryer për përlllogaritjen e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me burime të ligjshme ndërtimin e kësaj pasurie pas martesës, pra prej fundvitit 1999 deri në vitin 2003. Nga analiza e kryer në këtë version nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit rezultonte me një mungesë burimesh financiare të ligjshme për këtë pasuri, në vlerën 940.285 lekë.
6. Në përfundim, duke qenë se vlera prej 940.285 lekësh është e vetmja mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë, ndërtesë 3-katëshe, në Kavajë, si dhe e vetmja mungesë burimesh e identifikuar në kuadër të kontrollit të kriterit të pasurisë, në zbatim të nenit 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, ashtu si dhe shumica në këtë vendim, çmova se subjekti i rivlerësimit kishte arritur një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë, duke konkluduar që vendimi nr. 254, datë 04.06.2020, i Komisionit duhej të prishej, si dhe të urdhërohej ky i fundit për kryerjen e procesit të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të aftësive profesionale.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam kundër vendimit nr. 35 (JR), datë 22.09.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur prishja e vendimit nr. 254, datë 04.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe urdhërimi i tij që të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit për kriteret e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, për subjektin e rivlerësimit, znj. Entela Shedula.
2. Në konkluzion përfundimtar të vendimit nr. 254, datë 04.06.2020, Komisioni, pas hetimit të kryer, mbështetur në provat e administruara, ka konstatuar se: [...] *subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula: (i) nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, të parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve; (iii) ka deklarim të pasaktë në lidhje me të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat i bashkëshortit; (iv) deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
3. **Për pasurinë e paluajtshme të llojit ndërtesë, e përbërë nga godinë e kombinuar 3-katëshe: kati përdhes social ekonomik me sipërfaqe 139,3 m²; kati i parë me sipërfaqe 174,9 m²; dhe kati i dytë me sipërfaqe 174,9 m², e fituar me leje legalizimi në vitin 2016 dhe e regjistruar në emrin e subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe të bashkëshortit të saj, z. F. Sh., pranë ZVRPP Kavajë.**
4. Për këtë pasuri, çmoj se duhet të ndalem në disa momente të cilat i vlerësoj të rëndësishme për t'u analizuar dhe trajtuar, më pas, pasi t'i analizoj, do të jap arsyen pse jam plotësisht kundër me shumicën lidhur me vlerësimin e pasurisë objekt shqyrtimi, konkretisht:
 - i) *Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. F. Sh., për vitet 1991-1999, që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie.*
 - ii) *Kreditë nga Fondacioni B., të marra nga vetë subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe bashkëshorti i saj.*
 - iii) *Të ardhurat nga kredia e disbursuar në vitin 2005, pretenduar nga subjekti i rivlerësimit të përdorura për vitin 2006.*
 - iv) *Statusi juridik i truallit mbi të cilën është ngritur kjo banesë trekatëshe, objekt shqyrtimi.*

4.1. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit F. Sh., për vitet 1991-1999:

4.1.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti deklaroi se të ardhurat për ndërtimin e banesës *deri në këtë moment, janë nga puna e bashkëshortit F. Sh. si emigrant ekonomik në Itali nga viti 1991 e në vazhdim, i cili ka punuar sipas të dhënave nga INPS, për periudhën 1994, 1996, 1998, 1999, 2002, 2003.* Subjekti ka deklaruar të ardhura për këto vite, por shprehet në deklarim se: *këto fitime nuk i kam deklaruar më parë pasi nuk mund t'i siguroja, si dhe puna në të zezë, si të gjithë emigrantët e tjerë.*

4.1.2. Shumica e trupit gjykues, në paragrafin 51 të vendimit, arsyeton: *Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues çmon se kjo përllogaritje e gabuar e Komisionit nuk afekton analizën e kryer nga Komisioni për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme, për sa kohë subjekti të rivlerësimit nuk i është atribuar nga Komisioni ndonjë pasojë ligjore lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme të bashkëshortit, z. F. Sh., për kryerjen e këtij investimi, i cili rezultoi nga hetimi të jetë në një periudhë gjatë së cilës ky i fundit nuk gëzonte as statusin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, as statusin e personit të lidhur sipas parashikimeve të ligjit nr. 9049, datë*

10.04.2003, i ndryshuar. Për rrjedhojë, konkluzioni i mësipërm lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përlllogaritje të gabuar të vlerës së “godinës së kombinuar 3 kate”, çmohet pa efekt në zgjidhjen e çështjes.

4.1.3. Arsyetimi i përdorur nga shumica, çmoj se vjen tërësisht në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi Aneksi i Kushtetutës, në nenin D, pika 1 e tij parashikon se: *subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.*

4.1.4. Sipas kërkesave të kësaj dispozite, duhet që shumica e trupit gjykues të analizonte drejt situatën faktike, duke mos anashkaluar vlerën negative që do të rezultonte nëse kostoja e ndërtimit do të konsiderohej në vlerën 5.111.719 lekë si përlllogaritur nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, për periudhën 1995-1999, pa konsideruar si të ardhura të ligjshme, ato nga puna e bashkëshortit në emigracion. Nga përlllogaritjet, mbështetur në këtë arsyetim, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, do të rezultonte me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në vlerën -5.866.694 lekë.

4.1.5. Arsyetimin e shumicës e çmoj jo vetëm të gabuar dhe në favor të subjektit, por edhe në shkelje flagrante të parimeve kushtetuese dhe ligjore mjaft të qarta dhe lehtësisht të zbatueshme në rastin konkret. Diferenca negative e konstatuar konform ligjit, duhet të ngarkonte me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, që ka pasur detyrim ligjor për të justifikuar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*. Shumica ia heq këtë përgjegjësi ligjore subjektit të rivlerësimit me arsyetimin se bashkëshorti nuk ka pasur cilësinë e personit të lidhur për këtë periudhë, në një kohë që sot që po gjykohet, bashkëshorti ka cilësinë e personit të lidhur me subjektin, gjithashtu ZVRPP Kavajë konfirmon që kjo pasuri është në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit të saj, dhe subjekti i rivlerësimit banon prej 26 viteve tashmë në këtë banesë. Në vlerësimin tim, logjika e përdorur nga shumica se subjekti nuk ka detyrimin të deklarojë të ardhurat e bashkëshortit për periudhën në analizë, është absurde në raport me faktet, provat dhe parashikimet ligjore.

4.1.6. Për më tepër, ligji nr. 84/2016, në nenin 32, pika 1 e tij parashikon se: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të (bashkëshorti në rastin konkret), së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.* Pra, edhe kjo dispozitë ligjore e ngarkon subjektin e rivlerësimit të deklarojë saktë pasurinë për personat e lidhur, bashkëshortin etj. Në zbatim të kësaj dispozite, subjektet e rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, kanë bashkëlidhur formularët e deklaramit të pasurive për personat e lidhur për pasuritë e tyre prej origjinës së krijimit. Në këto kushte, shumica, në rastin Shedula, me një arsyetim të pabazuar në ligj, e zhvesh padrejtësisht subjektin nga përgjegjësia që i ngarkojnë dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Nga hetimi administrativ i kryer në Komision dhe në Kolegj, nuk u provuan nga subjekti i rivlerësimit ligjërisht të ardhurat e bashkëshortit, edhe pse iu dha mundësia për t’i paraqitur ato në seancën gjyqësore publike në Kolegj.

4.1.7. Për sa arsyetuar më sipër, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në vlerën -5.866.694 lekë, duke mos përfshirë në analizën financiare të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni, parashikuar nga neni 33/5/b i ligjit nr. 84/2016. Theksoj se Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, sipas vendimit të shumicës, ka përlllogaritur kosto ndërtimi në vlerën 5.111.719 lekë. Vlera negative e konstatuar është rezultat i

përlllogaritjeve të kryera në bazë të të dhënave të paraqitura në tabelën nr. 14 të vendimit të Komisionit, me konsideratë koston e ndërtimit të kalkuluar nga Njësia në Kolegj.

4.2. *Lidhur me huat nga Fondacioni B., në shumën 1.800.000 milion lekë:*

4.2.1. Komisioni, gjatë vlerësimit të kryer për këtë pasuri, periudhën e ndërtimit të banesës trekatëshe, në mungesë të dokumentacionit, e ka ndarë në faza të ndryshme, sipas pretendimeve të subjektit: si fazë të parë ka pretenduar vitet 1991-1999; fazë të dytë të ndërtimit, vitet 2000-2001; fazë të tretë, viti 2006; dhe fazë të fundit, përfundimin e ndërtimit, viti 2010.

4.2.2. Këto dy hua i janë financuar subjektit të rivlerësimit në vitet 2000-2001 nga Fondacioni B. dhe janë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, si një nga burimet e krijimit të kësaj pasurie. Nga analizimi i këtyre akteve, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, ka deklaruar vetëm dy kontratat e huas në emrin e saj, pa deklaruar dy kontrata të tjera huaje në emër të bashkëshortit të saj. E pyetur për sa sipër në Kolegj, subjekti ka deklaruar në seancë gjyqësore publike: *deklarimi i këtyre dy huave, kam menduar se përmbushte detyrimin e parashikuar, si dhe nuk kam pasur arsye për t'i fshehur dy huatë e tjera në emrin e bashkëshortit.*

4.2.3. Nga përmbajtja e kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.10.2000, mes huadhënësit, Fondacionit B., dhe huamarrësit, subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Sorra, me garant shtetasin K. Sh. (vjeherri i subjektit), rezulton se: *më datë 16.10.2000, midis Fondacionit B., në cilësinë e huadhënësit, dhe subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e huamarrëses, është lidhur një kontratë huaje për shumën 300.000 lekë, me një interes prej 24% në vit, për një periudhë 12-mujore. Sipas nenit 7 të kësaj kontrate, huamarrësi angazhohet të **përdorë kredinë në aktivitetin ekonomik “Tregti mallra industriale”**. Referuar nenit 9 të së njëjtës kontratë, si titull garancie për shlyerjen e kredisë parashikohet garanci me hipotekë mbi një shtëpi dykatëshe [...], e ndodhur në lagjen nr. {***}, Kavajë, në pronësi të vjeherit të subjektit të rivlerësimit, z. K. M. Sh..*

4.2.4. Më datë 28.03.2001, midis të njëjtave palë, ishte lidhur kontratë, e titulluar “Kontratë hipotekimi”, me objekt të përcaktuar në nenin 1 të saj: *Huadhënësi (Fondacioni B.) i jep hua znj. Entela Sorra shumën prej 600.000 lekësh, me një interes prej 24% në vit, për një periudhë 24-mujore. Referuar nenit 7 të kësaj kontrate: huamarrësi angazhohet ta **përdorë kredinë në aktivitetin ekonomik “Tregti konfeksione”**. Në bazë të nenit 9, kjo hua/kredi është siguruar me garanci hipotekare mbi pasurinë e paluajtshme si më sipër cituar, në pronësi të vjeherit të subjektit të rivlerësimit.*

4.2.5. Të njëjtat kontrata me sa më sipër referuar, me të njëjtin objekt, për të njëjtat vlera monetare, me të njëjtin qëllim përdorimi dhe të siguruara me hipotekë mbi pasurinë e paluajtshme në pronësi të shtetasit K. Sh., janë lidhur në të njëjtat data me sa më sipër referuar edhe mes Fondacionit “B.” në cilësinë e huadhënësit dhe bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, F. Sh., në cilësinë e huamarrësit.

4.2.6. Unë, gjyqtarja në pakicë, vlerësoj të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti nuk provoi me dokumentacion të ligjshëm se këto hua janë përdorur për ndërtimin e banesës dhe, me të drejtë, nuk i ka përfshirë ato në përlllogaritjet e kryera në analizë financiare, si të ardhura të ligjshme. Nën vlerësimin tim si gjyqtare në pakicë, ndryshimi i destinacionit të përdorimit të huas bie në kundërshtim me parashikimet e kontratës, duke bërë që njëra nga palët, subjekti i rivlerësimit, të ketë shkelur kushtet e marrëveshjes së nënshkruar.

4.2.7. Shumica e trupit gjykues në paragrafët 55 dhe 56 të vendimit ka konkluduar: *Në kuadër*

të verifikimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me qëllimin real të marrjes së këtyre kredive, trupi gjykues mori në analizë edhe bilancet e personit fizik F. Sh. me NUIS {***} për vitet 2000 dhe 2001, nga ku konstatoi se në zërin “Detyrime- shteti-tatime dhe taksa (TVSh)”, për vitin 2000 paraqitet shuma prej 148.281 lekësh, ndërsa për vitin 2001 shuma prej 15.549 lekësh. Gjithashtu, nga verifikimi i kryer nga trupi gjykues nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, u konstatua se në pasivin e bilancit, zëri “Detyrime të kërkueshme deri në një vit - hua nga bankat dhe institucionet e kreditit”, paraqitet me vlerë zero, çka nënkupton se nuk ka ndonjë shumë të paraqitur në bilance për të dyja vitet në lidhje me këtë lloj detyrimi.

4.2.8. Nga vlerësimi i të dhënave të konstatuara si më sipër, kuptohet se të vetmet detyrime të paraqitura në bilancet e viteve 2000 dhe 2001, janë ato për TVSh-në, çka konfirmon faktin se gjatë këtyre dy viteve financiare, nuk janë gjeneruar detyrime të tjera në emër të personit fizik, situatë kjo e ndryshme me rastin kur kreditë e marra pranë Fondacionit B. do të ishin përdorur për nevoja të personit fizik. Për rrjedhojë, referuar këtyre dy dokumenteve të dorëzuara pranë organit tatimor në përmbushje të detyrimeve ligjore që u lindin personave fizikë që ushtrojnë aktivitet tregtar, shlyerja e detyrimeve për kredinë nuk rezulton të jetë pasqyruar si detyrim i personit fizik. Në një interpretim logjik të fakteve të konstatuara si më sipër, trupi gjykues çmon se për sa kohë shlyerja e detyrimeve për kreditë e marra pranë Fondacionit B., në vlerën respektivisht të 600.000 lekëve për vitin 2000 dhe 1.200.000 lekëve për vitin 2001, nuk është përballuar nga personi fizik, fondet e këtyre kredive nuk duhet të jenë përdorur për nevojat e aktivitetit tregtar të personit fizik F. Sh., me NUIS {***}. Janë disa arsye për të cilat mbaj qëndrim kundër arsyetimit të përdorur nga shumica në çështjen konkrete. Nga dokumentacioni i administruar lidhur me praktikat e ndjekura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, dhe bashkëshorti i saj, kanë rezultuar kontrata huaje nënshkruar me Fondacionin B., në shumën totale 1.800.000 lekë, për periudhën 2000-2001, financiar **për ushtrimin e aktivitetit për biznes**, deklaruar nga subjekti në deklaratë e pasurisë vetting vetëm dy nga huat si burim krijimi për pasurinë objekt shqyrtimi.

4.2.9. Arsyetimin tim kundër konkluzionit të shumicës në paragrafin nr. 57: [...] Për rrjedhojë, trupi gjykues e gjeti të pabazuar konkluzionin e Komisionit për mosvlerësimin si burim të ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt kontrolli të vlerës prej 1.800.000 lekësh të përfutur nga kreditë e marra pranë Fondacionit B. në vitet 2000 dhe 2001, duke mos i marrë në konsideratë këto vlera monetare si të hyra në analizën financiare të viteve respektive – e argumentoj:

Së pari, me faktin se subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, ka nënshkruar këto kontrata huaje të cilat kanë fuqinë e ligjit për palët, duke qenë gjyqtare në detyrë, nënshkruan dhe merr hua për biznes, duke vepruar kështu në papajtueshmëri me parashikimet kushtetuese dhe ligjore të funksionit të gjyqtarit.

Së dyti, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, duke anashkaluar parimet dhe etikën që i kushtëzon ligji dhe funksioni që ushtron, pretendon se këto hua janë marrë për ndërtimin e shtëpisë së saj, pa e provuar pretendimin e saj me asnjë provë ligjore.

Së treti, shumica e trupit gjykues në arsyetim ndalet në analizën e bilancit të personit fizik “F. Sh.”, bashkëshortit të subjektit, të vitit 2001, nga ku konstatojnë se: 55. [...] në pasivin e bilancit, zëri “Detyrime të kërkueshme deri në një vit - hua nga bankat dhe institucionet e kreditit”, paraqitet me vlerë zero, çka nënkupton se nuk ka ndonjë shumë të paraqitur në bilance për të dyja vitet në lidhje me këtë lloj detyrimi. 56. [...] Në një interpretim logjik të fakteve të konstatuara si më sipër, trupi gjykues çmon se për sa kohë shlyerja e detyrimeve për kreditë e marra pranë Fondacionit B., në vlerën respektivisht të 600.000 lekëve për vitin 2000 dhe 1.200.000 lekëve për vitin 2001, nuk është përballuar nga personi fizik, fondet e këtyre kredive nuk duhet të jenë përdorur për nevojat e aktivitetit tregtar të personit fizik F. Sh., me NUIS {***}.

Pra, në asnjë rast, shumica e trupit gjykues nuk ka vlerësuar asnjë provë që pse subjekti i rivlerësimit nuk i ka deklaruar huat në bilancet tregtare të viteve 2000-2001, pasi realisht personi fizik “F.r Sh.” me NUIS {***}, duke mos i pasqyruar fare huat në bilancet financiare ose ka shkelur marrëveshjen me Fondin B., duke i tërhequr fondet për nevoja individuale, në shkelje të etikës tregtare, ose nuk deklaroi detyrimet ndaj palëve të treta në pasqyrat financiare [rrit xhiron, rrit fitimin e, për pasojë, rrit tatimin mbi fitimin].

Për sa më lart arsyetuar, a mundën anëtarët e shumicës, me këtë analizë të bërë, të përmbysin një mal me të pavërteta, pretendime të pambështetura në ligj dhe në asnjë provë nga subjekti i rivlerësimit?

Së katërti, supozojmë se qëndron pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, se ndërtimi i shtëpisë në pronësi të saj dhe të bashkëshortit, është bërë edhe me fondet e përfituara nëpërmjet huas së financuar nga Fondacioni B., me interes 2% në muaj, referuar kontratës së huas. Përse duhet të anashkalohej përdorimi i një huaje me interes të ulët për krijimin e pasurisë, ndërkohë që në nenin 7 të këtyre kontratave, është parashikuar se *huamarrësi/subjekti angazhohet të përdorë kredinë në aktivitetin e tij ekonomik të tregti mallra industriale, si dhe huamarrësi/subjekti pranon që Fondacioni B. ta verifikojë përdorimin e mirë të fondit të huazuar, në përputhje me programin e financimit të aneksuar në këtë kontratë.*

Nuk mjaftojnë gjithë këto veprime të kundërligjshme për të konkluduar se deklarimet e subjektit janë të pasakta, në cenim të besimit të publikut të drejtësia, mungesë e burimeve financiare të ligjshme për financimin e ndërtimit të kësaj banese me tri kate? Nënshkruan kontrata për biznes, pastaj në deklaratën e pasurisë *vetting* deklaroi se ka financuar ndërtimin e banesës 3 kate me këto hua, përdor një hua me interes të ulët 2% në muaj për ndërtimin e shtëpisë, lind pyetja: çfarë duhet të bëjë tjetër ky subjekt rivlerësimi për të mbajtur përgjegjësi ligjore lidhur me këtë pasuri? Prandaj jam kundër qëndrimit të mbajtur nga shumica, si në çdo çështje të gjykuar më parë ku kam konstatuar shkelje flagrante të zbatimit të ligjit, si në rastin konkret.

4.2.10. Në përfundim, unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Shedula, ka pasaktësi në deklarim për huat e përfituara nga Fondacioni B., si dhe pasaktësi në deklarimin e burimeve të krijimit të pasurisë objekt trekatësh, pasaktësi të shoqëruara me mungesë burimesh financiare të ligjshme dhe, me këto veprime të saj, ka cenuar besimin e publikut të drejtësia. Për sa më sipër arsyetuar, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe ndodhet në kushtet e parashikuara nga nenet 33, pika 5, gjerat “a” dhe “b” dhe 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

4.3. Lidhur me ndërtimin e katit të dytë të banesës trekatëshe në vitin 2006, me burim të ardhurat nga kredia në shumën 2.000.000 lekë, financuar nga Tirana Bank, disbursuar në vitin 2005:

4.3.1. [...] *Komisioni nuk mori në konsideratë si burim të ligjshëm për investim në ndërtesën 3-tre) katëshe të ardhurat nga kredia bankare, për faktin se subjekti e ka tërhequr të gjithë shumën e kredisë deri në gusht të vitit 2005, si dhe për faktin se subjekti nuk ka deklaruar gjendje “cash” në fund të vitit 2005. Për pasojë, nga analiza e kryer, ka rezultuar se për vitin 2006, subjekti ka rezultuar me një gjendje negative në shumën -1.631.673 lekë.*

4.3.2. Unë, si gjyqtare në pakicë, kam rezervë lidhur me arsyetimin e shumicës së anëtarëve të trupit gjykues në paragrafët 58 - 63 të vendimit, të cilët kanë konsideruar si të ardhura të ligjshme për ndërtimin e katit të tretë të banesës trekatëshe, të ardhurat nga kredia bankare, financuar subjektit nga Tirana Bank, në gusht 2005, pasi mosdeklarimi i gjendjes *cash* në fund të vitit 2005, i pjesës së mbetur të kredisë së disbursuar tërësisht në gusht të vitit 2005, të pretenduar se është

përdorur në vitin 2006, në vlerësimin tim, në kushtet kur nuk është pasaktësia e vetme e subjektit, më çon drejt konkluzionit të Komisionit për të mos e përfshirë mes të ardhurave të ligjshme. Fakti i tërheqjes së gjithë kredisë në muajin gusht të vitit 2005 dhe mosdeklarimi më tej i pjesës së kredisë së mbetur, pa lënë gjurmë, dhe pretendimi i saj në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006, se kjo kredi u përdor për ndërtimin e banesës në vitin 2006, vlerësoj se kredia e tërhequr edhe mund të jetë shpenzuar diku tjetër përderisa është tërhequr e tëra në këtë rast, dhe mbajtja *cash* në shtëpi deri në vitin 2006 nuk më bind në këtë rast, prandaj jam me analizën e bërë nga Komisioni, ku kjo pasaktësi shoqërohet edhe me mungesë të burime të ligjshme.

4.4. Lidhur me statusin juridik të truallit mbi të cilin është ndërtuar godina trekatëshe:

4.4.1. Në lidhje me pronësinë e truallit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004, është deklaruar shtëpi banimi me kat përdhes, kat të parë dhe kat të dytë karabina, ndërtuar në truall të përfutur me trashëgimi, ndërkohë që nga hetimi i Komisionit, pranuar edhe nga deklaratimet e subjektit, rezultoi se përfitimi i kësaj pasurie nuk ishte me trashëgimi, por pasuri/truall që rezulton në emër të shtetit, të konfirmuar edhe nga dokumentacioni gjatë hetimit administrativ. Në lidhje me pronësinë mbi truallin ku është ndërtuar pasuria, subjekti ka parashtruar se kjo është pasuri e trashëguar e familjes Shedula dhe banesa e ndërtuar ndodhet mbi truallin e kthyer me vendim të K.K.K Pronave nr. {***}, datë 21.4.1994. [...] *Nisur nga fakti që trualli mbi të cilin ndodhet godina 3-katëshe, pozicionohet në pasurinë nr. {***} vol. {***}, f. {***}, e cila figuron edhe sot në emër të shtetit, trupi gjykues çmon se subjekti nuk ka bërë deklaram të saktë në deklaratën “vetting” dhe atë periodike për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, e cila duhet të ishte deklaruar sipas statusit ligjor që ka pasur kjo pasuri, të dokumentuar edhe nga aktet që depozitoi subjekti me vendimin e K.K.K Pronave nr. {***}, datë 21.4.1994 dhe shkresën e ASHK-së Kavajë nr. {***} prot., datë 2.3.2020.* Konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri është se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe atë periodike për mënyrën e fitimit të pronësisë së truallit mbi të cilin është ngritur ndërtesa 3-katëshe, e cila sipas Komisionit, duhej të ishte deklaruar sipas statusit ligjor që ka pasur kjo pasuri.

4.4.2. Shumica e trupit gjykues ka konkluduar se: [...] *kjo situatë e paqartë në drejtim të veprimeve për regjistrimin e titujve të pronësisë pranë ZVRPP Kavajë, nuk sjell ndonjë implikim për subjektin e rivlerësimit në kuadër të procesit të rivlerësimit. Kjo, për sa kohë u provua se origjina e pasurisë tokë truall mbi të cilin është ngritur ndërtimi 3-katësh, i legalizuar, rrjedh nga një akt i Komisionit të Kthim Kompensimit të Pronave, i nxjerrë në bazë të parashikimeve ligjore të kohës, në vitin 1994 dhe se, nga hetimi i kryer nga Komisioni, nuk është ngritur asnjë dyshim për përfshirje të paligjshme të subjektit të rivlerësimit në këtë proces.*

4.4.3. Unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se deklarimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula, në deklaratën e interesave privatë 2004, ka qenë ndryshe nga deklarimi i saj në deklaratën e pasurisë *vetting*. Dokumentacioni i administruar tregon se familja Shedula, referuar vendimit nr. {***}, datë 21.04.1994, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ka përfutur pronësinë e truallit me sipërfaqe 3608 m² [...].

4.4.4. Në kuadër të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, me kërkesën për marrje dokumentacioni pranë ASHK-së, Drejtoria Vendore Kavajë, nga përgjigjet e dhëna nga ky institucion me shkresën nr. {***}, datë 02.03.2020, e informon se: [...] *ju njoftojmë se leja e legalizimit nr. {***} është regjistruar me nr. pasurie {***}, vol. {***}, f. {***}, në emër Shtet. Po nga e njëjta drejtori, nga i njëjti person, me të njëjtin numër protokoll {***}, por më datë 06.03.2020 (katër ditë më pas), është kthyer përgjigjja tjetër: [...] se banesa ndodhet mbi truallin e kthyer me vendimin e KKKP Kavajë.*

4.4.5. Ndodhur në situatën kur subjekti në deklarin e vitit 2004, deklaroi se trualli është përfituar me trashëgimi, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting* nuk e përmend këtë truall, por vetëm ndërtesën 3-katëshe, çmoj se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarin të pasaktë lidhur me statusin juridik të kësaj pasurie. Për këtë arsye, vlerësoj se hetimi i Komisionit ka qenë jo i plotë dhe arsyetimi i shumicës jobindës.

5. Në përfundim të sa më sipër arsyetuar, shumica e trupit gjykues, në vlerësimin tim, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, duhet të dispononte me lënien në fuqi të vendimit nr. 254, datë 04.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Shedula nga detyra e gjyqtares, pasi, sipas rrethanave të mësipërme dhe parashikimeve ligjore, ajo nuk duhet të jetë në radhët e gjyqtarëve të sistemit të drejtësisë.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi